

REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

Nr. 2455 Rep.

Nr. 534 Kol.



KONTRATË SHITJE KUOTSH
(PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE TË KAPITALIT)

Sot, më datë 08 / 11 / 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), përpara meje, Stela R. Demneri, notere, anëtare e Dhomës së Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në Rr. "Gjik Kuqali", P. Ferar, K.1, Nr.13, u paraqitën personalisht palët:

PALA SHITËSE:

Shoqëria "MGB" sh.p.k, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NUIS K91323004Q, e regjistruar në QKB më datë 23.01.2009, me seli në adresën Fshati Linzë, Rruga Nacionale Tiranë - Dajt, e përfaqësuar nga administratori **Z. Hergys RRELI**, atësia Naim, lindur më 24.09.1981, në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letrnjofimit me nr. personal I10924042Q.

(në vijim referuar si "Shitësi")

PALA BLERËSE:

Fondacioni "FIRDEUS", regjistruar m Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 576, datë 15.12.2016, pajisur me NIPT Nr.. L71627453O, me zyrë qendore në Tiranë, adresë rruga Ali Demi, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv **Z. Ilir NAÇI**, lindur më 03.11.1971, në Tiranë, dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. personal H11103031L.

(në vijim referuar si "Blerësi")

Palët kontraktuese hartojnë këtë kontratë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil; Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar); Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar); Ligjit 110/2018, "Për Noterinë"; Statutit të Shoqërisë "MGB" sh.p.k dhe Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë të datës 07.11.2019; Statutit të Fondacionit "FIRDEUS" dhe Vendimit të Bordit Drejtues të Fondacionit datë 31.10.2019 me kushtet e mëposhtme:

Të dhëna paraprake:

1. Pala shitëse në bazë të Ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, datë 08.11.2019, zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "SPITALI CONTINENTAL" sh.p.k, NUIS L51308022F, me vlerë totale prej ALL 100.000.000 (njëqind milionë Lekë) të cilat korespondojnë

me 1 (një) kuotë në shoqërinë "SPITALI CONTINENTAL" sh.p.k (në këtë kontratë referuar si "Kompania Target").



2. Pala shitëse në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "SPITALI CONTINENTAL" sh.p.k, ka shprehur vullnetin e saj në vendimin e datës 07.11.2019 që ti transferojë nëpërmjet shitblerjes Palës Blerëse 100% të kuotave të kapitalit që ai zotëron në shoqërinë "SPITALI CONTINENTAL" sh.p.k, duke përcaktuar çmimin e blerjes dhe ka autorizuar administratorin e saj **z. Hergys RRELI**, që të lidhë në emër dhe për llogari të Palës Shitëse kontratën për shitblerjen e kuotës së kapitalit.
3. Shitësi deklaron në këtë Kontratë se Kompania Target është regjistruar në regjistrin tregtar, ka marrë licencën përkatëse për të ofruar shërbime spitalore, dhe ushtron aktivitetin përkatës në përputhje të plotë me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar.
4. Shitësi deklaron në këtë Kontratë, se kuotat e Kompanisë Target, objekt i këtij veprimi juridik, nuk janë përdorur si mjet për sigurimin e ekzekutimit të ndonjë detyrimi, pra, nuk janë objekt i ndonjë barre, i cfarëdolloj forme apo natyre, dhe janë të lira për kalimin e pronësisë me cfarëdo lloj veprimi juridik të lejueshëm nga legjislacioni shqiptar.
5. Shitësi dhe Blerësi kanë personalitet juridik, ushtrojnë aktivitetin në përputhje me ligjin, dhe nuk kanë ndonjë pengesë korporative apo të cdo lloj forme për të hyrë në këtë veprim juridik.

Palët, me cilësinë që u njeh ligji në Republikën e Shqipërisë dhe me vullnet të lirë, bien dakord të hartojnë, nënshkruajnë dhe respektojnë këtë marrëveshje si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

- 1.1 Sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë, Shitësi transferon nëpërmjet shitjes tek Blerësi 100% (njëqind për qind) të kuotave të kapitalit të Kompanisë Target, me vlerë ALL 100.000.000 (njëqind milionë) Lekë të cilat korespondojnë me 1 (një) Pjesë/Kuotë pjesë të kapitalit, dhe Blerësi pranon dhe blen nga Shitësi të gjithë të drejtat dhe detyrimet lidhur me këtë kuotë.
- 1.2 Palët bien dakord dhe kuptojnë se shumica e çmimit të blerjes do të jetë përfundimtare dhe çmimi që Blerësi do të paguajë për shitblerjen është çmim maksimal dhe Shitësi garanton Blerësin se ky i fundit nuk do të paguajë ndonjë çmim tjetër përveç çmimit të blerjes. Pa kundërshtuar sa më sipër, çmimi i blerjes nuk do të përfshijë pagesat për regjistrimin ose transferimin e pronësisë mbi Kuotën, nëse është e aplikueshme, të cilat do të paguheshin nga Blerësi.
- 1.3 Shitësi pranon se është përgjegjës për të paguar detyrimet tatimore (të tilla si tatimet mbi kapitalin, tatimi mbi fitimin, tatimin mbi të ardhurat dhe çdo detyrim tjetër) që lidhen me blerjen në pajtim me ligjin në fuqi nëse ka ndonjë të tillë. Për shmangien e dyshimit, Blerësi do të jetë përgjegjës për kostot e transaksionit (si kosto noteriale e të ngjashme me këto), të cilat do të mbulohen nga Blerësi.
- 1.4 Shitësi pranon se është përgjegjës për të paguar drejtpërsëdrejti në organet tatimore ose për të kompensuar Blerësin për detyrime tatimore, taksa apo detyrime të tjera të cfarëdolloj forme apo natyre, që mund t'i ngarkohen Kompanisë Target në të ardhmen nga organet tatimore apo organe të tjera shtetërore, si rezultat i një kontrolli tatimor, apo cfarëdolloj kontrolli tjetër, në

Kompaninë Target për periudha të mëdha apo kohore deri në castin / datën e kalimit të pronësisë së kuotës tek Blerësi.

- 1.5 Shitesit angazhohet të mbajë një aktivitet normal tregtar dhe kontabel në intervalin kohor që pason datën e Bilancit deri në ditën e transferimit të pronësisë mbi kuotën, duke shmangur veprimet që sjellin ndryshime/devijime madhore të llogarive kontabel, mardhenieve tregtare me të tretet (kontrata furnizimi, kontrate qera ambjenti, kontrate qera paisje), marrëdhëniet me të punësuarit dhe aktiveve të trupezuara.
- 1.6 Shitesit në këtë Kontratë heq dorë në mënyrë të përvokueshme nga çdo kufizim në transferim (duke përfshirë të drejtat e parablerjes, etj.) që mund të ekzistojnë në lidhje me kuotat, qoftë sipas neneve të Statutit të Kompanisë Target, ndonjë kontrate apo ligjeve përkatëse.
- 1.7 Shitesit deklaron që i ka dhënë Blerësit çdo informacion të saktë dhe të vertetë mbi statusin ligjor, gjendjen dhe performancën financiare dhe ekonomike të Kompanisë Target, dhe se asnjë organ / institucion shtetëror apo pale e tretë nuk ka asnjë pretendim ndaj Kompanisë Target duke qenë se Kompania Target ka ushtruar aktivitetin në përputhje me ligjin dhe ka respektuar çdo kontrate apo marrëveshje dhe ka shlyer çdo detyrim kontraktor, të çfaredolloj forme apo natyre, të maturuar apo të pagueshëm deri në datën e kalimit të kuotave.
- 1.8 Mbi bazën e pikës 1.7 me sipër, Blerësi deklaron se është në dijeni mbi statusin ligjor, financiar dhe ekonomik të Kompanisë Target; statusi financiar provohet me Kontabilitetin e brendshëm të Spitalit Continental të datës 30.09.2019, i vendosur në dispozicion të Blerësit. Mbi bazën e pikës 1.7 me sipër, çdo pretendim i ndonjë organi / institucioni shtetëror apo pale të tretë ndaj Kompanisë Target apo Shitesit që mund të ngrihet në të ardhmen për veprimtarinë e Kompanisë Target apo Shitesit deri në datën e kalimit të kuotave (shih nenin 4 më poshtë) është detyrim dhe përgjegjësi e Shitesit dhe do t'i kundërdrejtohet Shitesit.
- 1.9 Kompania Target ka titull të mirë dhe të tregtueshëm të gjitha asetëve pronë e Kompanisë Target, të cilat janë fituara ligjrisht dhe janë të lira nga çdo barrë e çfaredo lloji forme apo natyre.
- 1.10 Pa kundërshtuar sa me sipër, Shitesit është përgjegjës dhe merr përsipër çdo detyrim të sotëm apo të ardhshëm që lidhet me shoqërinë SPITALI CONTINENTAL SHPK dhe me asetëve të saj përpara çdo gjykate a arbitrazhi ose ndonjë trupi qeveritar, agjenti apo zyrtari që lidhet me objektin e aktivitetit apo veprimtarinë e Kompanisë Target apo asetet e saj deri në castin / datën e kalimit të pronësisë së kuotave të Kompanisë Target.

Neni 2

Çmimi i shitjes dhe mënyra e likuidimit

- 2.1 Çmimi total i Blerjes së 100 % të kuotave të Kompanisë Target është shuma prej 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) Euro ose ekuivalenti në Lekë llogaritur me kursin e këmbimit 1 Euro = 123.7 Lekë. Blerësi do të paguajë Çmimin e Blerjes tek Shitesit me anë të transferes bankare në llogarinë ose llogaritë e përcaktuara nga Shitesit si llogari të ndërmjetme (Escrow Account) të Noterit:

Banka: CREDINS BANK

Numër llogarie: 00000905570

SWIFT: CDISALTRXXX

IBAN: AL33 2121 1140 0000 0000 0090 5572

Pagesa e Cmimit të Blerjes së kësaj Kontrate do të kryhet menjehere në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate;



- 2.2** Pagesa e Cmimit të Blerjes do të kryhet nga Noteri tek Shitesi pas regjistrimit të Bleresit si pronar i Kompanisë Target në regjistrin tregtar (Qendren Kombëtare të Biznesit - QKB) dhe pas dorezimit të ekstraktit përkatës të perditesuar tek Bleresi. Bleresi nuk ka asnjë përgjegjësi në lidhje me mospagimin ose vonesat në pagesë të Cmimit të Blerjes të shkaktuara nga Noteri.
- 2.3** Në shkëmbim për shitjen në fjalë dhe transferimin nga Shitesi tek Bleresi të kuotës së Kompanisë Target, Bleresi bie dakord të paguajë Cmimin e Blerjes sipas pikes 2.1 me sipër. Në ditën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Bleresi transferon në llogarinë bankare të ndërmjetme të Noterës Cmimin e Blerjes dhe mandati i transferimit, përfshihet si shtojcë në këtë Kontratë. Me përmbushjen e kushteve të specifikuar në pikën 2.2 të kësaj Kontrate, Noteri duhet të transferojë Cmimin e Blerjes në llogarinë e Shitesit si më poshtë:

Banka: Credins BANK

Numër Llogarie: 00000238272

SWIFT: CDISALTRXXX

IBAN: AL86 2121 1205 0000 0000 0023 8272

Neni 3

Nënshkrimi

- 3.1** Në momentin e nënshkrimit, Shitesi ka dorëzuar tek Bleresi Vendimin të Asamblesë së Përgjithshme të Shitesit për miratimin dhe autorizimin e transaksioneve të parashikuara në këtë Kontratë.
- 3.2** Në momentin e nënshkrimit, Bleresi ka dorëzuar tek Shitesi Vendimin e Bordit të Drejtoreve të Fondacionit "FIRDEUS" për miratimin dhe autorizimin e transaksioneve të parashikuara në këtë Kontratë.

Neni 4

Casti i kalimit të titullit të pronesisë së kuotave

- 4.1** Casti i kalimit të pronesisë së kuotave të Kompanisë Target nga Shitesi tek Bleresi është pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe regjistrimit dhe perditesimit të këtij veprimi juridik në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).
- 4.2** Regjistrimin e këtij veprimi juridik në QKB duhet të kryejë Shitesi brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Në të kundërt, Bleresi kryen regjistrimin përkatës në QKB.

Neni 5

Taksat dhe tatimet

Cdo takse ose tatim i zbatueshëm mbi këtë veprim juridik, të tilla si tatim mbi fitimin kapital, apo taksa mbi kalimin e kuotave, etj., nëse janë të zbatueshme, është përgjegjësi e Shitesit.



Neni 6

Ligji i zbatueshem dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 6.1 Kjo Kontrate eshte hartuar ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar i cili eshte ligji udheheqes i kesaj Kontrate. Per ceshnje te paparashikuara ne kete Kontrate zbatohen dispozitat perkatese ligjore.
- 6.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me kete Kontrate gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, do te zgjidhet miqesisht midis Palëve. Ne te kundert, mosmarrëveshja e cila nuk mund të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët, do t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 7

Te ndryshme

- 7.1 Nëse ndonjë pjesë e kësaj Kontrate konsiderohet si e pavlefshme ose pa fuqi ligjore për çdo lloj arsyeje nga një gjykatë ose autoritet qeveritar me juridiksion kompetent, atëherë kjo pjesë do të çmohet si e pavlefshme dhe pjesa tjetër e kësaj kontrate do të vazhdojë të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë;
- 7.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve dhe zëvendëson çdo komunikim tjetër me shkrim lidhur me te para nënshkrimit të saj. Kjo Kontrate nuk mund të ndryshohet apo shtohet përveçse me shkrim dhe të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të dy Palëve.

Neni 8

Forcat madhore

- 8.1 Asnjëra nga Palët nuk do të mbajë përgjegjësi kundrejt tjetrës për mospërmbyllje të detyrimeve të tyre sipas kësaj Kontrate kur performanca e tyre vonohet, pengohet ose ndalohet në rast të ndonjë Force Madhore;
- 8.2 Për qëllime të kësaj Kontrate, me "Forcë Madhore" do të kuptohet një ngjarje apo ndodhi që është përtej kontrollit të arsyeshëm të Palëve, e paparashikueshme, e pashmangshme, dhe që e bën të pamundur realizimin e detyrimeve të Palëve sipas kësaj Kontrate dhe që në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohet e pamundur në rrethanat e ndodhura, dhe si objekt i këtyre kërkesave, përfshin, por pa u kufizuar në, luftra, kryengritje, trazira civile, tërmete, zjarre, shpërthime, stuhitë, përmytje ose kushte të tjera atmosferike të jashtëzakonshme, grevat, mbyllje të aktivitetit prodhues nga pronarët, apo veprime të tjera industriale, konfiskime apo çdo veprim tjetër nga agjensitë Qeveritare.

Neni 9

Emërimi i përfaqësuesve

- 9.1 Palët do të emërojnë secili prej tyre një përfaqësues që do të mbajë përgjegjësi për marrëdhënien midis Palëve lidhur me realizimin e objektit të Kontratës;
- 9.2 Palët do të njoftojnë me shkrim për emrin dhe të dhënat e tjera të përfaqësuesve të tyre. Palët gëzojnë të drejtën që në çdo kohë të ndryshojnë përfaqësuesin e tyre duke i paraqitur më parë Palës tjetër një njoftim me shkrim. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 9.3 Çdo njoftim ose komunikim tjetër që kërkohet ose lind si nevojë e zbatimit të kësaj kontrate, do të jetë me shkrim dhe mund të dërgohet dorazi por me shënimet përkatëse nga sekretariteti ose protokollet e palëve, ose me postë të regjistruar elektronike me konfirmim marrje në dorëzim tek

selia e palës marrëse ose në adresa të tjera të njoftuara më parë me shkrim nga palët, dhe ky njoftim ose komunikim do të konsiderohet si i dërguar rregullisht kur është marrë në dorëzim nga pala tjetër.



Kjo kontratë është hartuar në 6 (gjashtë) kopje të njëjta, njëra nga të cilat mbetet në Zyrën e Noterisë, dy të tjerat janë nga një për secilën palë, dhe një për tu depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kontrata ju lexua palëve qartë, dhe pasi unë noterja u sigurova se palët e kuptuan përmbajtjen e saj dhe se kjo kontratë shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

PALA SHITËSE

Shoqëria "MGB" sh.p.k

Përfaqësuar nga Z. Hergys RRELI

Hergys Reli

PALA BLERËSE

Fondacioni "FIRDEUS"

Përfaqësuar nga Z. Ilir NAÇI

Ilir Naçi

NOTERE
STELA R. DEMNËRI

VENDIM I ORTAKËVE TE SHOQERISE "MGB SH.P.K."

Sot me date 07 nentor 2019, u mbajt mbledhja e ortakëve të shoqërisë "MGB" sh.p.k, shoqëri e regjistruar pranë QKB në datë 23/01/2009, me NIPT K91323004Q dhe me seli në adresën Fshati Linze, Rr Nacionale Tirane-Dajt, objekti në tëje ndërtimi me vendimin Nr.336/2, ZK 2460, Nr Pasurie 603/11, Tirane.

Ne mbledhje moren pjesë ortakët e shoqërisë:

Z.Robert Bano, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur në datë 01/09/1972, në Skrapar, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 024729143 dhe me nr. personal H20901230W, i cili zoteron 34% të kapitalit të nenshkruar.

Z.Hergys Rreli, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur në datë 24/09/1981, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 024532859 dhe me nr. personal I10924042Q, i cili zoteron 33% të kapitalit të nenshkruar.

Z.Fatmir Isufaj, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur në datë 13/05/1975, në Potom, Skrapar, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 032949503 dhe me nr. personal N50313171R, i cili zoteron 33% të kapitalit të nenshkruar.

Pasi moren në shqyrtim pikat e rendit të dijes si më poshtë:

Miratimin e propozimit për shitjen e 1 kute që përfaqëson 100% të kapitalit të zotëruar në shoqërinë Spitali Continental sh.p.k., me NIPT L51308022F me seli në adresën: Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Ali Demi, ambientet e ish-Kombinavit Poligrafik, Godina 2-kt, ngjitur me Kryegjyshaten, Tirane dhe kapital themeltar me vlerë 100.000,000 (njëqind milion) leke.

Bleres i propozuar është Fondacioni "FRIDEUS" me seli në Rr. "Ali Demi" Nr. 25, kati parë, Tirane me themelues dhe kryetar bordi z.Elvis Naçi.

Ortakët e Shoqërisë vendosën si më poshtë vijon:

1. Ortakët janë dakort të shesin 1 kute që përfaqëson 100% të kapitalit të zotëruar në shoqërinë Spitali Continental sh.p.k., me NIPT L51308022F, me seli në adresën: Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Ali Demi, ambientet e ish-Kombinavit Poligrafik, Godina 2-kt, ngjitur me Kryegjyshaten, Tirane dhe kapital themeltar me vlerë 100,000,000 (njëqind milion) leke. Çmimi i shitjes është 350.000 (treqinda e pesëdhjetë mijë) euro ose ekuivalenti në leke në kurs këmbimi 1 euro =123.7 leke.

Bleres i 1 kute që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë Spitali Continental sh.p.k, do të jetë Fondacioni "Firdeus" i regjistruar me Vendim Nr. 576 datë 15.12.2016, të Gjykatës

se shkallës së parë Tiranë, me NPT L7162/2015, me themelues dhe kryetar bordi z.Elvis Naçi.

2. Në mbështetje të Kodit Civil dhe legjislacionit tregtar, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë z.Hergys Rrelli, autorizohet të administrojë të gjitha çështjet e nevojshme, për nënshkrimin e të gjithë dokumentave dhe/ose kontratave për shitjen e lehtë.
3. Shitesi është i disponueshëm, për ofrimin e asistencës dhe dhënien e çdo informacioni, të gjykuar të nevojshëm dhe të kërkuar nga blerësi, për një periudhë 30 ditore nga nënshkrimi i kontratës së shitjes. Kjo periudhë mund të shtyhet deri në afatit maksimal në datë 31.12.2015.
Shitesi angazhohet të asistojë blerësin në verifikimin e dokumentacionit kontraktual, lajeve dhe licensave të disponueshme, kontratat e punës, evidencat operacionale mbi numrin e pacientëve, llojet e shërbimeve të ofnuara, arsimet e aplikuar, burimet njerëzore, etj.
4. Depozitimin e këtij vendimi pranë QKB-së dhe DKT Tiranë, sipas afateve të përcaktuara në ligj.

Ortaket e shoqërisë MGB"shpk

Z.Robert Bano

Robert Bano

Z.Hergys Rrelli

Hergys Rrelli



Z.Fatmir Isufaj

FATMIR ISUFAY



Mbledhje e Bordit Drejtues te Fondacionit Firdeus

Date 31 tetor 2019

Address

Rruga Ali Demi Nr.25
Tirane, Albania

www.firdeus.al
info@firdeus.al
+35567 400 6161

Te pranishem:

Anetare Bordi

Elvis Naci	Kryetar	Florian Brinja	Anetar
Marvi Naci	Anetar	Fatime Naci	Anetar
Andi Qinami	Anetar		

Te ftuar:

Drejtori Ekzekutiv Ilir Naci
Drejtor Finance Altin Allmuca

Drejtori Ekzekutiv Ilir Naci, ne vijim te vendimit te marre ne muajin korrik 2019 per te hulumtuar mbi hapesirat per nje strukture shendetsore, i paraqiti Bordit propozimin per te blere kuotat e Spitalit Continental SHPK.

Bordi i Fondacionit Firdeus, i njoftuar dhe mbledhur rregullisht sipas dispozitave ligjore dhe te statutit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtori i Finances lidhur me situaten financiare dhe juridike te SPITALI CONTINENTAL SHPK me NIPT L51308022F, si dhe duke marre ne konsiderate situaten financiare te Fondacionit Firdeus sipas Pasqyrave Financiare te miratuara ne korrik 2019,

VENDOSI:

1. Te miratoje propozimin e paraqitur dhe Fondacioni Firdeus te bleje 100 % te kuotave te shoqerise SPITALI CONTINENTAL SHPK me NIPT L51308022F, bazuar ne Kontraten e Shitblerjes qe do te lidhet per kete qellim.
2. Te autorizoj z. Ilir Naci me karte identiteti 029187906, ne cilesine e Drejtorit Ekzekutiv, qe te firmose ne emer dhe per llogari te Fondacionit Firdeus Kontraten e Shitblerjes se 100 % te kuotave te shoqerise SPITALI CONTINENTAL SHPK me NIPT L51308022F, me cmimin 350,000 (treqind e pesedhete mije) Euro ose ekuivalenti ne Leke (1 Euro = 123.7 Leke).
3. Te autorizoj z. Ilir Naci me karte identiteti 029187906, ne cilesine e Drejtorit Ekzekutiv, te kryeje te gjitha procedurat e regjistrimit ne QKB te kalimit te pronesise se kuotave te SPITALI CONTINENTAL SHPK me NIPT L51308022F, si dhe te kryeje te gjitha njoftimet e nevojshme ne te gjitha organet perkatese shtetore.

Bordi vendosi gjithashtu qe te pergatitet nje plan veprimi per hapat qe do te ndermerren nga Fondacioni Firdeus lidhur me sherbimet qe merren nga Spitali Amerikan dhe ky plan te paraqitet per aprovim brenda muajit dhjetor 2019.

Vendimet u miratuan nga te gjitha anetaret

Elvis Naci (Kryetar)

Elvis Naci

Marvin Naci (Anetar)

Marvin Naci

Fatime Naci (Anetar)

Fatime Naci

Andi Qinami (Anetar)

Andi Qinami

Florian Brinja (Anetar)

Florian Brinja

DHOMA E NOTERISË TIRANË

Noter: Saimir S. SHATKU

Studio: Sheshi: "Avni Rustemi"

Rruga "Hoxha Tahsim", Pall. "Vjero"

Tel.: + 04/2250583/Mob. 0672557851

Nr. 2646 Rep.

VËRTETIM NOTERIAL

(Njësime me origjinalin)

Unë Noteri Saimir S. Shatku, vërtetoj se dokumenti/at i fotokopjuar/a me titullin e mëposhtëm:

***Vendim për Regjistrimin e Personit Juridik, me nr. 576 vendimi, dt. 15.12.2016.**

Shtetasit, iu bënë të qarta pasojat dhe përgjegjësitë ligjore dhe morale që sjell një dokument i falsifikuar apo me përmbajtje jo të vërtetë.

Lëshuar më 28/12 /2016, me kërkesë të shtetasit/es: **Elvis NAÇI**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. **026076036** dhe me nr. personal: **H70407042N**.

Vërtetohet se dokumenti/at janë të njëjtë me origjinalin, të cilat nuk kanë korrigjime, shtesa, fshirje apo shenja të tjera të veçanta.

Vërtetimi i dokumenteve të bashkëlidhura bëhet në përputhje me Nenin 56 të Ligjit 7829, datë 01/06/1994 "Për Noterinë" dhe të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë me Nr. 6291, pika 7, datë 17/08/2005.

NOTER
SAIMIR S. SHATKU



A large, stylized handwritten signature in black ink, which appears to be 'Shatku'.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË



Nr. Akti _____

Nr. Vendimi 576



PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot, më datë 15.12.2016, unë gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kujtim Vraniçi, mora në shqyrtim kërkesën e Z. Elvis Naçi, i cili kërkon të regjistrohet si person juridik Fondacioni "FIRDEUS" dhe,

KONSTATOVA:

Se kërkuesi Z. Elvis Naçi, me cilësinë e Themeluesit të Fondacionit "FIRDEUS", kërkon të regjistrohet si person juridik Fondacioni "FIRDEUS", me themelues atë vetë.

Fondacioni nuk është një organizatë politike fitimprurëse.

Qëllimi i Fondacionit "FIRDEUS" është:

1. Të kryejë veprimtari të ndryshme, të krijojë, aplikojë dhe të përkrahë programe me karakter humanitar.
2. Të kryejë veprime të cilat konsistojnë në ofrimin e shërbimeve falas, kujdes për të gjitha moshat dhe gjinitë e njerëzve, me qëllim mirëqenie, ruajtje e mbrojtje dinjiteti dhe sigurimin e përmirësimit të cilësisë së jetës.
3. Të ndihmojë familjet në nevojë.
4. Të nxisë dhe të krijojë mundësi për punësimin e të rinjve.
5. Të promovojë solidaritetin mes njerëzve dhe krijimin e mundësive të arsimit.
6. Të hapë kurse të ndryshme profesionale (rrobaqepësi, kurse në gjuhë të huaja, etj).
7. Të mbështesë dhe marrë masa për ngritjen e një sistemi efikas të ndihmës psikologjike të njerëzve të traumatizuar dhe të ndihmës emergjente në raste të fatkeqësive natyrore.
8. Të krijojë mundësitë e hapjes së ambienteve të veçanta, ku do të bëhet e mundur ofrimi i shërbimeve të ndryshme për njerëz në nevojë.
9. Të kryejë veprimtari për ngritjen dhe sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme shoqërore, edhe aktivitete fetare.
10. Krijimin e kushteve bamirëse me qëllim arsimimi e edukimi, sigurimin e mbështetjes të teknologjisë së lartë për të përmirësuar kujdesin shëndetësor, nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore nëpërmjet inicimit, administrimit,

zbatimit të projekteve konkrete, të koncepteve dhe praktikave në fushat përkatëse në përputhje me vlerat e organizatës.

11. Krijimin dhe administrimin e projekteve apo organizmave të tjera si persona juridikë ose jo, për realizimin e programeve të ndryshme të zhvillimit në fushën mjekësore, të përkujdesjes shëndetësore, të edukimit të të gjitha niveleve, në përmbushje të qëllimit të Fondacionit.
12. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme sipas qëllimit të fondacionit në fushën shëndetësore, sociale, shpirtërore, kulturore, atë ekonomike, dhe të fushave të tjera shoqërore.
13. Sigurimin e mbështetjes së nevojshme për aktivitetet dhe programet e Fondacionit, nëpërmjet ndihmës apo kontributit të personave fizikë apo juridikë, vendas ose të huaj.
14. Promovimin e qëllimit dhe aktivitetit të Fondacionit apo të projekteve të ndryshme, përmes medias televizive, radiofonike, të shtypshkruar, apo internetit, si dhe çdo platforme tjetër të komunikimit masiv.
15. Administrimin e pasurisë së Fondacionit në përmbushje të qëllimit të Fondacionit.
16. Monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe programeve të Fondacionit për realizimin me cilësi të qëllimit të Fondacionit.
17. Sigurimin dhe zbatimin në praktikë nga vetë Fondacioni apo nëpërmjet projekteve apo programeve të tij, të koncepteve dhe praktikave inovative në fushat e mbuluara nga qëllimi i Fondacionit.
18. Ofrimin e ndihmës praktike dhe shërbimeve në të gjitha aspektet e nevojshme për projektet, programet apo organizatat e krijuara nga Fondacioni në përmbushje të qëllimeve të Fondacionit.
19. Ofrimin dhe krijimin e mundësive apo platformave të ndryshme, si dhe ngritjen e grupeve të këshillimit për zhvillimin e diskutimeve në fushat të cilat përfshihen në qëllimin e Fondacionit.
20. Çdo lloj aktiviteti tjetër që çmohet i arsyeshëm në të mirë dhe në interes të publikut, i parashikuar ose jo në qëllimin e Fondacionit dhe që nuk është ndaluar shprehimisht me ligj.

Selia e Fondacionit "FIRDEUS" ndodhet në adresën: Rr. "Zonja Çurre", Pallati "Ermit-Stari", kati 1, Tiranë, Shqipëri.

Fondacioni "FIRDEUS" do të zhvillojë aktivitetin për një periudhë kohe të pacaktuar.

Struktura e Organeve Drejtuese të Fondacionit përbëhet nga Bordi Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.

Bordi Drejtues përbëhet nga:

- Elvis Naçi
- Muharrem Naçi
- Florian Brinja

Drejtor Ekzekutiv, do të jetë Z. Ilir Naçi.

Vlera fillestare e pasurisë së Fondacionit "FIRDEUS" është 100.000 (një qind mijë) lekë.

Mjetet financiare të organizatës jofitimprurëse ndër të tjera janë dhe donacionet nga subjektet fizikë apo juridikë privatë vendas ose të huaj.



Për gjithë sa më lart dhe bazuar në dokumentimin e paracituar, kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të nenit 39, 55 e vijues, të Kodit Civil, si dhe ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" dhe ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar,

VENDOSA:

Pranimin e kërkesës.

Regjistrimin si person juridik të Fondacionit "FIRDEUS", me themelues Elvis Naçi.

Fondacioni nuk është një organizatë politike fitimprurëse.

Qëllimi i Fondacionit "FIRDEUS" është:

1. Të kryejë veprimtari të ndryshme, të krijojë, aplikojë dhe të përkrahë programe me karakter humanitar.
2. Të kryejë veprime të cilat konsistojnë në ofrimin e shërbimeve falas, kujdes për të gjitha moshat dhe gjinitë e njerëzve, me qëllim mirëqenie, ruajtje e mbrojtje dinjiteti dhe sigurimin e përmirësimit të cilësisë së jetës.
3. Të ndihmojë familjet në nevojë.
4. Të nxisë dhe të krijojë mundësi për punësimin e të rinjve.
5. Të promovojë solidaritetin mes njerëzve dhe krijimin e mundësive të arsimimit.
6. Të hapë kurse të ndryshme profesionale (trobapësi, kurse në gjuhë të huaja, etj).
7. Të mbështesë dhe marrë masa për ngritjen e një sistemi efikas të ndihmës psikologjike të njerëzve të traumatizuar dhe të ndihmës emergjente në raste të fatkeqësive natyrore.
8. Të krijojë mundësitë e hapjes së ambienteve të veçanta, ku do të bëhet e mundur ofrimi i shërbimeve të ndryshme për njerëz në nevojë.
9. Të kryejë veprimtari për ngritjen dhe sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme shoqërore, edhe aktivitete fetare.
10. Krijimin e kushteve bamirëse me qëllim arsimimi e edukimi, sigurimin e mbështetjes të teknologjisë së lartë për të përmirësuar kujdesin shëndetësor, nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore nëpërmjet inicimit, administrimit, zbatimit të projekteve konkrete, të koncepteve dhe praktikave në fushat përkatëse në përputhje me vlerat e organizatës.
11. Krijimin dhe administrimin e projekteve apo organizmave të tjera si persona juridikë ose jo, për realizimin e programeve të ndryshme të zhvillimit në fushën mjekësore, të përkujdesjes shëndetësore, të edukimit të të gjitha niveleve, në përmbushje të qëllimit të Fondacionit.
12. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme sipas qëllimit të fondacionit në fushën shëndetësore, sociale, shpirtërore, kulturore, atë ekonomike, dhe të fushave të tjera shoqërore.
13. Sigurimin e mbështetjes së nevojshme për aktivitetet dhe programet e Fondacionit, nëpërmjet ndihmës apo kontributit të personave fizikë apo juridikë, vendas ose të huaj.

14. Promovimin e qëllimit dhe aktivitetit të Fondacionit apo të projekteve të ndryshme, përmes medias televizive, radiofonike, të shtypshkruar, apo internetit, si dhe çdo platforme tjetër të komunikimit masiv.
15. Administrimin e pasurisë së Fondacionit në përmbushje të qëllimit të Fondacionit.
16. Monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe programeve të Fondacionit për realizimin me cilësi të qëllimit të Fondacionit.
17. Sigurimin dhe zbatimin në praktikë nga vetë Fondacioni apo nëpërmjet projekteve apo programeve të tij, të koncepteve dhe praktikave inovative në fushat e mbuluara nga qëllimi i Fondacionit.
18. Ofrimin e ndihmës praktike dhe shërbimeve në të gjitha aspektet e nevojshme për projektet, programet apo organizatat e krijuara nga Fondacioni në përmbushje të qëllimeve të Fondacionit.
19. Ofrimin dhe krijimin e mundësive apo platformave të ndryshme, si dhe ngritjen e grupeve të këshillimit për zhvillimin e diskutimeve në fushat të cilat përfshihen në qëllimin e Fondacionit.
20. Çdo lloj aktiviteti tjetër që çmohet i arsyeshëm në të mirë dhe në interes të publikut, i parashikuar ose jo në qëllimin e Fondacionit dhe që nuk është ndaluar shprehimisht me ligj.

Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

U shpall në Tiranë, sot më datë 15.12.2016

GJYQATAR
KUJTIM VRANIÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 257 Rep

VËRTETIM
I NJËSISË SË KOPJES MË ORIGINALIN

Sot më datë 30 Tetor 2018 (Dymijë e tetëmbëdhjetë), ditën e Marte përpara meje **Noteres** së Dhomës së Noterisë Tiranë **Aida E. SHAMETI** me seli në Rrugën "Asim Vokshi", Kompleksi "USLUGA", u paraqit personalisht shtetasi:


Altin ALLMUÇA i biri i Azis dhe i Zyhra lindur ne Berat me 05. 11. 1975 banues ne Tirane (sipas deklarimit te tij), me adrese Rruga "Zef Jubani", pallati 6/1, hyrja 1, apartamenti 2, shtetas shqiptar, për identitetin e te cilit e verifikova nga leternjoftimi me numer 031156485 dhe numer personal H51105105T me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili më kërkoi njësimin me origjinalin të dokumentit:

Statuti i Fondacionit "FIRDEUS".

Unë Noterja, pasi verifikova fotokopjen, duke e krahasuar me dokumentin origjinal, konstatoj se fotokopja nuk ka korrigjime, shtesa, fshirje, apo shenja të tjera të veçanta, te ndryshme nga dokumenti origjinal.

Pasi i bëj të ditur personit të sipërshënuar pasojat juridike penale në rast të paraqitjes së dokumentave të falsifikuara apo të modifikuara, për të cilat ai vetë mban përgjegjësi, unë noteri vërtetoj se njësia është kopje e njëjtë me dokumentin origjinal në bazë të Nenit 56 të Ligjit Nr 7829, datë 01. 06. 1994 "Për Noterinë" i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë Nr 6291, datë 17.08.2005.

Notere
Aida SHAMETI





STATUTI

I

Fondacionit "FIRDEUS"

Sot më datën 09.11.2016, në Tiranë, Shqipëri, Z. Elvis Naçi shtetas shqiptar, lindur më 07.04.1977, në Tiranë, mbajtës i Kartës të Identitetit me nr. H70407042V; shpreh vullnetin e tij për themelimin e Fondacionit "FIRDEUS" dhe mbështetur në dispozitat e Kodit Civil dhe të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, harton këtë Statut, me përmbajtje si më poshtë:

KREU I

DISPOZITÄ TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Themeluesi

1.1 Krijohet Fondacioni "FIRDEUS", në formën e një organizate jofitimprurëse.

1.2 Themelues i Fondacionit "FIRDEUS" është Z. Elvis Naçi.

Neni 2

Lloji, Emri dhe Vula

2.1 Fondacioni "FIRDEUS" (referuar më poshtë si Fondacioni) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse, që mbështet dhe zhvillon tek individë dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbrojtjetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut.

2.2. Vula e Fondacionit është në ngjyrën blu, në formë të rrumbullakët dhe do të përmbajë emrin 'Fondacioni FIRDEUS' dhe vendin e themelimit të Fondacionit, 'Tiranë, Albania'.

2.3 Emri dhe Vula e Fondacionit duhet të figurojnë në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del nga Fondacioni.

2.4 Në marrdhëniet me organizmat e huaja ose në pjesëmarrjet në veprimtari ndërkombëtare, do të njihet me emërtimin anglisht 'Foundation FIRDEUS'.

Neni 3
Selia

3.1 Selia e Fondacionit "FIRDEUS" ndodhet në adresën: Rr. "Zonja Çurre", Pallati "Ermir-Star", kati 1, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Vendndodhja e selisë mund të ndryshohet me vendim të Bordit Drejtues.

Neni 4
Shtrirja Territoriale

4.1 Fondacioni "FIRDEUS" zhvillon aktivitetin e tij pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Fondacioni "FIRDEUS" mund të krijojë degë të tij në çdo njësi tjetër administrativo-territoriale të Shqipërisë.

4.2 Fondacioni "FIRDEUS" njëkohësisht mund të çelë degë ose filiale edhe në shtete të huaja, sipas legjislacionit të vendeve përkatëse.

Neni 5
Qëllimi dhe Objekti

5.1 Fondacioni "FIRDEUS" ka për qëllim dhe si fushë të veprimtarisë së vet:

1. Të kryejë veprimtari të ndryshme, të krijojë, aplikojë dhe të përkrahë programe me karakter humanitar.
2. Të kryejë veprime të cilat konsistojnë në ofrimin e shërbimeve falas, kujdes për të gjitha moshat dhe gjinitë e njerëzve, me qëllim mirëqenie, ruajtje e mbrojtje dinjiteti dhe sigurimin e përmirësimit të cilësisë së jetës.
3. Të ndihmojë familjet në nevojë.
4. Të nxisë dhe të krijojë mundësi për punësimin e të rinjve.
5. Të promovojë solidaritetin mes njerëzve dhe krijimin e mundësive të arsimit.
6. Të hapë kurse të ndryshme profesionale (rrobaqepësi, kurse në gjuhë të huaja, etj).
7. Të mbështesë dhe marrë masa për ngritjen e një sistemi efikas të ndihmës psikologjike të njerëzve të traumatizuar dhe të ndihmës emergjente në raste të fatkeqësive natyrore.
8. Të krijojë mundësitë e hapjes së ambienteve të veçanta, ku do të bëhet e mundur ofrimi i shërbimeve të ndryshme për njerëz në nevojë.
9. Të kryejë veprimtari për ngritjen dhe sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme shoqërore, edhe aktivitete fetare.
10. Krijimin e kushteve bamiëse me qëllim arsimimi e edukimi, sigurimin e mbështetjes të teknologjisë së lartë për të përmirësuar kujdesin shëndetësor, nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore nëpërmjet

inicimit, administrimit, zbatimit të projekteve konkrete, të koncepteve dhe praktikave në fushat përkatëse në përputhje me vlerat e organizatës.

11. Krijimin dhe administrimin e projekteve apo organizmave të tjera si persona juridikë ose jo, për realizimin e programeve të ndryshme të zhvillimit në fushën mjekësore, të përkujdesjes shëndetësore, të edukimit të të gjitha niveleve, në përmbushje të qëllimit të Fondacionit.
12. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme sipas qëllimit të fondacionit në fushën shëndetësore, sociale, shpirtërore, kulturore, atë ekonomike, dhe të fushave të tjera shoqërore.
13. Sigurimin e mbështetjes së nevojshme për aktivitetet dhe programet e Fondacionit, nëpërmjet ndihmës apo kontributit të personave fizikë apo juridikë, vendas ose të huaj.
14. Promovimin e qëllimit dhe aktivitetit të Fondacionit apo të projekteve të ndryshme, përmes medias televizive, radiofonike, të shtypshkruar, apo internetit, si dhe çdo platforme tjetër të komunikimit masiv.
15. Administrimin e pasurisë së Fondacionit në përmbushje të qëllimit të Fondacionit.
16. Monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe programeve të Fondacionit për realizimin me cilësi të qëllimit të Fondacionit.
17. Sigurimin dhe zbatimin në praktikë nga vetë Fondacioni apo nëpërmjet projekteve apo programeve të tij, të koncepteve dhe praktikave innovative në fushat e mbuluara nga qëllimi i Fondacionit.
18. Ofrimin e ndihmës praktike dhe shërbimeve në të gjitha aspektet e nevojshme për projektet, programet apo organizatat e krijuara nga Fondacioni në përmbushje të qëllimeve të Fondacionit.
19. Ofrimin dhe krijimin e mundësive apo platformave të ndryshme, si dhe ngritjen e grupeve të këshillimit për zhvillimin e diskutimeve në fushat të cilat përfshihen në qëllimin e Fondacionit.
20. Çdo lloj aktiviteti tjetër që çmohet i arsyeshëm në të mirë dhe në interes të publikut, i paparashikuar ose jo në qëllimin e Fondacionit dhe që nuk është ndaluar shprehimisht me ligj.

Neni 6 Kohëzgjatja

6.1 Fondacioni "FIRDEUS" do të zhvillojë aktivitetin për një periudhë kohe të pacaktuar.

6.2 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Fondacionit mund të ndryshohet me vendim të Bordit Drejtues.

Neni 7 Ndalimi i Shpërndarjes së Fitimeve

Ndalohej çdo formë e shpërndarjes së fitimit ose përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e Fondacionit "FIRDEUS", prej personave që janë subjekt i Statutit, Aktit të Themelimit, rregulloreve dhe çdo akti tjetër të Fondacionit, përveç detyrimeve në formën e pagave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës dhe kontrata të tjera të ngjashme ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi për llogari të organizatës jofitimprurëse.

KREU II KAPITALET

Neni 8 Burimet Financiare

8.1 Vlera fillestare e pasurisë së Fondacionit "FIRDEUS" është 100.000 (një qind mijë) lekë, e krijuar si kontribut fillestar i themeluesit dhe e derdhur në llogarinë bankare të Fondacionit.

8.2 Burimet e të ardhurave të organizatës jofitimprurëse janë të ardhurat nga kuotizacioni kur ka të tilla, fonde, grante dhe dhurimet/donacionet e ofruara nga subjektet fizikë apo juridikë privatë vendas ose të huaj, nga veprimtaria e Fondacionit në përputhje me qëllimin dhe objektin e tij bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse.

Neni 9 Kriteret e Administrimit të Pasurisë

9.1 Fondacioni "FIRDEUS" bën shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë për të cilën është krijuar si dhe për drejtimin e mirëmbajtjen e pasurisë së vet.

9.2 Të gjitha të ardhurat që Fondacioni fiton nëpërmjet veprimtarisë së tij ekonomike dhe me çdo lloj tjetër mënyre fitimi, përdoren vetëm për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë Statut dhe në Aktin e Themelimit.

9.3 Fondet financiare ose ato materiale të dhuruara nga donatorë të ndryshëm me destinacion përdorimi të përcaktuar duhet të përdoren pa ndryshuar destinacionin e tyre me përjashtim të rasteve kur kjo është e pamundur apo kur është dhënë miratimi nga vetë donatorët.

9.4 Marrëdhëniet e Fondacionit "FIRDEUS" me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

9.5 Fondacioni është disponues dhe posedues i pasurisë së tij. Pasuritë e tij të luajtshme e të paluajtshme janë në dispozicion të zgjerimit të shërbimeve që përputhen me përcaktimet e këtij Statuti. Ato mund të shpërndahen ose transferohen vetëm me vendim të Bordit Drejtues dhe miratim të themeluesit.

9.6 Fondacioni hap llogari rrjedhëse në bankë. Nëpërmjet bankës ai kryen veprimtari ekonomik-financiare me partnerë vendas ose të huaj, duke likuiduar me monedhë shqiptare ose të huaj, duke respektuar dispozitat ligjore.

9.7 Fondacioni mund t'u japë shpërblim financiar anëtarëve të organeve drejtuese dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të tij në rastet kur ata përmbushin detyra të caktuara, si dhe ndihmë financiare punonjësve, personave të jashtëm ose subjekteve të tjerë nga fondi i vet. Masa e shpërblimit apo ndihmës, rastet, mënyra e dhënies, etj., përcaktohen nga Bordi Drejtues.

KREU III ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 10

Organet Drejtuese të Fondacionit

10.1 Organet Drejtuese të Fondacionit janë:

1. Bordi Drejtues (BD)
2. Drejtori Ekzekutiv (DE)

Neni 11

Bordi Drejtues

A. Përbërja

- 11.1 Bordi Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Fondacionit "FIRDEUS".
- 11.2 Themeluesi i Fondacionit është anëtar i parë i Bordit Drejtues.
- 11.3 Bordi Drejtues përbëhet nga së paku 3 (tre) anëtarë.
- 11.4 Anëtarët e Bordit Drejtues e ushtrojnë këtë detyrë pa afat, ata e ndërpresin atë vetëm sipas rasteve dhe mënyrave të përcaktuara në Statut.

B. Emërimi dhe Shkarkimi i Anëtarëve të Bordit Drejtues

- 11.5 Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit Drejtues bëhet nga vetë mbledhja e Bordit. Emërimi bëhet pas kërkesës së paraqitur nga vetë kandidati, e cila shqyrtohet në mbledhje ndërsa vendimi merret me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- 11.6 Për herë të parë emërimi i anëtarëve bëhet nga themeluesi i Fondacionit.
- 11.7 Anëtarët e Bordit Drejtues mund të shkarkohen me vendim të Bordit Drejtues. Shkarkimi i anëtarit bëhet kur ai ka shkelur Statutin, Aktin e Themelimit, ose rregulloret e brendshme të Fondacionit. Vendimi për shkarkimin duhet të merret nga shumica e anëtarëve në mbledhje.

Anëtari i propozuar për shkarkim nuk merr pjesë në votim por ka të drejtë të mbrojë veten e tij para Bordit Drejtues. Për shkarkimin e anëtarit nuk nevojitet asnjë provë përveç realizimit të marrjes së vendimit me shumicën e anëtarëve në mbledhje.

11.8 Nëse ndonjë nga anëtarët e Bordit Drejtues për arsye të ndryshme nuk përmbush anëtarësinë e tij, emërohet një tjetër anëtar për t'a zëvendësuar.

C. Kompetencat e Bordit Drejtues

11.9 Bordi Drejtues përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen, vendos për çështjet si më poshtë vijon:

- Ndryshimin e Statutit dhe të Aktit të Themelimit.
- Transformimin, ndarjen ose bashkimin e Fondacionit me fondacione të tjera.
- Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë, kërkon dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre.
- Nxjerr rregullore, norma dhe akte për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe miraton strukturat e organizatës.
- Emëron Kryetarin e Bordit Drejtues.
- Me propozim të themeluesit të Fondacionit emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv dhe kontrollon realizimin e detyrave dhe veprimtarinë e tij.
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit, miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Fondacionit dhe shpenzimet për vitin në vazhdim.
- Miraton, kontrollon dhe jep këshilla për buxhetin e Fondacionit të paraqitur nga Drejtori Ekzekutiv dhe donatorët.
- Krijon komitete të posaçme, krijon organizma të tjera vendimmarrëse ose këshillimore.
- Autorizon direkt persona për të kryer detyra të caktuara.
- Vendos për vetëshpërndarjen e Fondacionit dhe destinacionin e pasurisë së mbetur, si dhe për çdo çështje tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

D. Mbledhja dhe Vendimmarrja e Bordit Drejtues

11.10 Bordi Drejtues mbledhet të paktën 1 (një) herë në vit, por mund të mbledhet dhe më shumë se një herë në vit kur kjo kërkohe nga të një e treta e anëtarëve të tij ose nga Drejtori Ekzekutiv për raste emergjente.

11.11 Thirrja e anëtarëve të Bordit Drejtues bëhet me shkrim, jo më vonë se 1 (një) javë nga dita e mbledhjes. Njoftimi dërgohet në adresën e deklaruar në selinë e Fondacionit "FIRDEUS" nga secili anëtar. Ftesa duhet të përmbajë dhe rendin e ditës të mbledhjes. Mosmarrja e njoftimit për shkak të ndryshimit të adresës është përgjegjësi e vetë anëtarit. Mbledhja zhvillohet edhe kur nuk është respektuar afati i njoftimit me kusht që prezent në mbledhje të jenë të gjithë anëtarët që përbëjnë Bordin Drejtues.



11.12 Mbledhja e Bordit Drejtues mbahet dhe është e vlefshme me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve. Anëtarët të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk mund të marrin pjesë në mbledhje detyrohen të njoftojnë Kryetarin jo më vonë se 5 ditë para datës së mbledhjes. Nuk lejohet përfaqësimi në mbledhje i një anëtar nga një anëtar tjetër apo persona të tjerë të autorizuar prej tij.

11.13 Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Bordit Drejtues i cili zgjidhet nga mbledhja me vendimin e shumicës së anëtarëve që e përbëjnë atë. Ai qëndron në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe është i rizgjedhshëm. Kompetencat e Kryetarit të Bordit Drejtues kufizohen vetëm për organizimin e mbledhjes, thirrjen, drejtimin dhe mbarëvajtjen e saj. Në rastet kur Kryetari nuk është prezent në mbledhje ai zëvendësohet përkohësisht nga një anëtar tjetër i zgjedhur nga mbledhja për këtë qëllim.

11.14 Vendimet e Bordit Drejtues merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Çdo anëtar ka të drejtën e vetëm një vote.

11.15 Proces verbal i mbledhjes mbahet nga njëri prej anëtarëve. Kjo detyrë bëhet me qarkullim ndërmjet anëtarëve. Procesverbalet e mbledhjeve dhe vendimet duhet të mbahen në regjistrat përkatës dhe me rregull kronologjik dhe në fund procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës ndërsa vendimi i zbardhur firmoset nga Kryetari i Bordit Drejtues dhe nga personi që e ka mbajtur atë vendim.

Neni 12 Drejtori Ekzekutiv

12.1 Drejtori Ekzekutiv është organi më i lartë ekzekutiv i Fondacionit.

12.2 Rregullat e veprimtarisë së organit më të lartë ekzekutiv caktohen nga Statuti, dhe rregulloret e brendshme të Fondacionit.

12.3 Drejtori Ekzekutiv në veprimtarinë e përditshme ekzekuton detyrat, programet, projektet, dhe akte të tjera të vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës/drejtues i organizatës.

12.4 Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Bordi Drejtues për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

12.5 Paga dhe përfitime të tjera të mundshme të tij vendosen nga Bordi Drejtues.

12.6 Drejtori Ekzekutiv mban përgjegjësi përpara Bordit Drejtues për të gjithë veprimtarinë që kryen në ushtrimin e funksionit dhe detyrave të tij.

12.7 Kompetencat kryesore të Drejtorit Ekzekutiv, ndërmjet të tjerave janë:

- Angazhohet me veprimtarinë e përditshme dhe ekzekutimin e detyrave, programeve, projekteve të miratuara nga Bordi Drejtues.
- Lidh dhe nënshkruan marrëveshje dhe kontrata në emër të Fondacionit në përputhje me vendimet e Bordit Drejtues.
- Kryen veprime bankare me llogarinë e Fondacionit.

- Punëson personel me pagesë sipas vendeve vakante të përcaktuara nga Bordi Drejtues
- Emëron, shkarkon dhe ngarkon me detyra brenda specialitetit të tyre pjesëtarët e Administratës dhe kontrollon punën dhe veprimtarinë që ata realizojnë.
- Angazhon persona dhe profesionistë të fushave të ndryshme me detyra të caktuara si bashkëpunëtorë të Fondacionit me ose pa shpërblim.
- Kontrollon mbarëvajtjen administrative të Fondacionit dhe harton lidhur me të një raport të hollësishëm të cilin i'a paraqet Bordit Drejtues çdo 6 muaj ose më shpesh kur i kërkohet prej Bordit Drejtues.
- Në mbledhjen vjetore të Bordit Drejtues paraqet raportin përfundimtar vjetor dhe atë financiar.
- Informon Bordin Drejtues për çështjet që vlerëson se duhet t'i paraqiten, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me ndryshimin e Statutit, Aktit të Themelimit dhe Rregullores.
- Harton projekte të reja lidhur me aktivitetin e Fondacionit "FIRDEUS" dhe i'a paraqet për miratim Bordit Drejtues.
- Përfaqëson Fondacionin para autoriteteve kombëtare e ndërkombëtare, vetë ose nëpërmjet një personi të caktuar prej tij ose me vendim Bordit Drejtues.
- Mban lidhje dhe korrespondencë me organizata homologe brenda dhe jashtë vendit.
- Paraqet para Bordit Drejtues të Fondacionit çështje që i takojnë atij për vendimmarrje.
- I propozon Bordit Drejtues diskutimin e çështjeve të caktuara dhe miratimin e akteve përkatëse në përputhje me parimet bazë të Fondacionit.
- Ndjek zbatimin e buxhetit dhe veprimtarinë financiare të Fondacionit, realizimin e veprimtarive të tij, ushtron kontroll për përdorimin e fondeve të donatorëve në projekte të ndryshme.
- Organizon punën përgatitore për zhvillimin e mbledhjeve të organeve drejtuese/vendimmarrëse dhe sigurimin e të gjithë mbështetjes teknike për drejtuesit e tyre në realizimin e funksioneve përkatëse.
- Mbikqyr respektimin e rregulloreve të brendshme të Fondacionit të miratuara nga Bordi Drejtues.
- Firmos dokumentet e Fondacionit që u drejtohen të tretëve.
- Organizon punën për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, takimeve, seminarëve dhe konferencave, të cilat organizohen nga Fondacioni.
- Në raste urgjente merr masat e domosdoshme dhe menjëherë informon Bordin Drejtues.

Neni 13 Përfaqësimi





13.1 Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit është personi që përfaqëson Fondacionin në marrdhëniet me personat e tretë fizikë dhe juridikë.

13.2 Ai përfaqëson Fondacionin në të gjitha llojet e marrdhënieve juridike që Fondacioni krijon e lidh me subjektet, vendas apo të huaj, apo institucionet shtetërore.

13.3 Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Fondacionin dhe në proceset gjyqësore kur është palë në gjykim Fondacioni, në rast mosmarrëveshje dhe sipas rastit cakton avokat për ndjekjen e çështjeve gjyqësore ose zgjidhjen e problemeve të ndryshme ligjore.

13.4 Me miratim të Bordit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv mund t'i delegojë përkohësisht apo pjesërisht kompetencat e tij, njërit prej punonjësve të Fondacionit që ai gjykon.

13.5 Deri në emërimin e Drejtorit Ekzekutiv nga mbledhja e parë e Bordit Drejtues, funksionet e përfaqësimit i kryen Z. Elvis Naçi, si themelues i Fondacionit.

Neni 14

Ndryshimi i Statutit dhe Aktit të Themelimit Miratimi i Rregulloreve

14.1 Organi vendimmarrës për ndryshimin e Statutit apo Aktit të Themelimit është Bordi Drejtues.

14.2 Ndryshimet mund të propozohen nga secili anëtar. Propozimet paraqiten me shkrim shoqëruar edhe me argumentat përkatës dhe dërgohen jo më vonë se 30 ditë përpara mbledhjes së Bordit.

14.3 Vendimi për ndryshimin e Statutit dhe të Aktit të Themelimit merret me shumicën e anëtarëve pjesëmarrës në mbledhjen e Bordit Drejtues.

14.4 E njëjta procedurë ndiqet për miratimin apo ndryshimin e Rregulloreve të brendshme të funksionimit.

Neni 15

Vlera Zyrtare e Akteve të Fondacionit

15.1 Aktet dhe korrespondenca e Fondacionit kanë vlerë zyrtare kur ato përmbajnë emrin e plotë ose të shkurtuar të tij, logon, selinë, numrin dhe datën e vendimit të regjistrimit të Fondacionit në gjykatën përkatëse, emrin dhe nënshkrimin e personit kompetent konform përcaktimeve të këtij Statuti e rregulloreve të organeve drejtuese.

15.2 Dokumentet që rregullojnë marrdhëniet me bankat ose me organet tjera të sistemit financiar, nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv, si firmë e parë dhe në mungesë të tij nga një person tjetër kurdoherë i pajisur me autorizim dhe/ose prokurë me shkrim.

Neni 16

Administrata

16.1 Organizimi dhe Struktura e Administratës të Fondacionit përcaktohet nga Bordi Drejtues.

16.2 Administrata e Fondacionit drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 17

Marrdhëniet e Punës

17.1 Marrdhëniet e punës së Fondacionit rregullohen konform dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

17.2 Fondacioni për nevojat e tij punëson individë, vendas dhe të huaj duke respektuar legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë.

17.3 Personeli me pagesë nuk mund të marrë pjesë në organet vendimmarrëse të Fondacionit.

17.4 Rolin e punëdhënësit e kryen Drejtorit Ekzekutiv, i cili lidh kontratën përkatëse duke u bazuar në kriteret e Fondacionit dhe përcaktimet e Kodit të Punës.

17.5 Drejtuesit dhe punonjësit e tjerë të Fondacionit janë të detyruar të zbatojnë kushtet e këtij Statuti, rregulloreve të brendshme të funksionimit dhe të kontratës të nënshkruar me Fondacionin gjatë ushtrimit të detyrave/funksioneve të tyre.

Neni 18

Përgjegjësia e Anëtarëve të Organeve Drejtuese dhe Punonjësve

Themeluesi i Fondacionit, Bordi Drejtues dhe punonjësit e Fondacionit "FIRDEUS" përgjigjen për detyrimet e Fondacionit ndaj të tretëve vetëm në rastet kur gjatë ushtrimit të detyrës me dashje ose nga pakujdesia e rëndë i kanë shkaktuar dëm të tretëve.

Neni 19

Bilancet Financiare

19.1 Veprimet ekonomiko-financiare të Fondacionit fillojnë më datë 1 Janar dhe mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik, duke bërë përjashtim për vitin e parë.

19.2 Bilanci financiar e ekonomik duhet të përfundohet nga personat e ngarkuar brenda 3 mujorit të parë të vitit pasardhës, i cili shqyrtohet nga Bordi Drejtues.

Neni 20

Bashkimi dhe Ndarja

Fondacioni "FIRDEUS" mund të transformohet, ndahet ose bashkohet me fondacione të tjera sipas kushteve që parashikon ligji dhe me vendim të Bordit Drejtues.

ARTIKULLI 21
KANË

Neni 21

Shpërndarja e Fondacionit

21.1 Fondacioni mund të vetëshpërndahet me vendim të organit të saj më të lartë Bordit Drejtues, në rast se:

- Fondacioni ka realizuar qëllimin;
- kur është bërë i pamundur realizimi i tij për arsye të ndryshme;
- si edhe për çdo rast tjetër që çmohet nga Bordi Drejtues.

21.2 Sipas rasteve dhe mënyrës së parashikuar në ligj Gjykata mund të vendosë shpërndarjen e Fondacionit. Në këtë rast të gjitha kompetencat që ka Bordi Drejtues, i kalojnë Gjykatës sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Neni 22

Likuidimi

22.1 Në rast të mbylljes së veprimtarisë dhe të vetshpërndarjes së Fondacionit, në çdo kohë ose për çdo arsye, Bordi Drejtues cakton një ose më shumë likuidatorë për zhvillimin e procesit të likuidimit. Likuidimi i Fondacionit bëhet në bazë të dispozitave që përcaktohen nga ligji.

22.2 Likuidatorët në të gjitha rastet kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetet, pasurinë dhe përfaqësimin e Fondacionit që nga dita e emërimit të tyre deri në përfundim të likuidimit. Likuidatorët veç të tjerash vlerësojnë pasurinë e mbetur dhe kujdesen që ajo të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga Statuti, Bordi Drejtues, gjykata ose ligji.

22.3 Raporti Përfundimtar i përgatitur nga Likuidatorët miratohet nga Bordi Drejtues dhe me pas ky i fundit kërkon ç'regjistrimin e Fondacionit në gjykatë. Kur Bordi Drejtues refuzon miratimin e Raportit Përfundimtar çështja zgjidhet nga gjykata.

22.4 Bordi Drejtues në vendimin për vetëshpërndarjen ose në atë të miratimit të Raportit Përfundimtar të likuidimit, përcakton edhe subjektet të cilëve do t'u kalojë pasuria e mbetur si dhe pjesën takuese të secilit.

Neni 23

Përbërja e Organeve të Para Drejtuese

23.1 Anëtarë të Bordit Drejtues, janë:

- Elvis Naçi, themelues i Fondacionit.
- Mubarem Naçi.
- Florian Brinjaj.



**KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT**

24.1 Fondacioni "FIRDEUS" do të ketë personalitetin e vet juridik qysh nga dita e regjistrimit në gjykatë, sipas dispozitave ligjore në Republikën e Shqipërisë.

24.2 Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar.

Ky Statut hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje me vlerë dhe fuqi të njëjtë.

Ky Statut dhe Akti i Themelimit u firmosën nga Themeluesi.

THEMELUESI

Z. Elvis NACI

Elvis - Naci



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE AIDA SHAMETI
Nr. 262 Rep.



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me datë 09 Nentor 2016 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë) ditën e Merkurë, unë Notere **AIDA SHAMETI**, anëtare e dhomës së noterisë Tiranë, me zyrë në adresën Rruga "Reshit Petrela", Kompleksi i Pallateve "USLUGA", Tiranë, redaktoj këtë vërtetim nënshkrimi me kërkesë të personit të identifikuar më poshtë:

Elvis NAÇI i biri i Muharrem e Dylbere lindur ne Tirane me 07. 04. 1977, banues në Tiranë, (deklaruar prej tij) me adrese Lagja "Ali Demi", shtetas shqiptar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi me numër personal H70407042V, me cilësinë e themelusit te Fondacionit "FIRDEUS".

Personi e mësipërm është madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili nënshkroi sot në praninë time dokumentin bashkëlidhur Statuti i Fondacionit "FIRDEUS" të redaktuar jashtë kësaj zyre noteriale.

Unë noterja pasi e gjeta në përputhje me parashikimet e ligjit "Ligjit për Noterinë", e vërtetoj rregullisht nënshkrimin e tij në aktin bashkëlidhur.

NOTERE
AIDA E SHAMETI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
ZYRA E REGJISTRIT TE OJF-ve

Tirane me 17.10.2019

VERTETIM

Me vendimin nr. 576, date 15.12.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte regjistruar si person juridik organizata jofitimpruese e emertuar **Fondacioni "FIRDEUS"**; me seli ne Tirane, Rruga "Zonja Çurre", Pallati "Ermir – Star", kati 1; me kohezgjatje te papercaktuar; me themelues Elvis Naçi; Bordi Drejtues Elvis Naçi, Muharrem Naçi, Florian Brinja; Drejtor ekzekutiv eshte z. Ilir Naçi; qellimi fondacionit eshte: te kryeje veprimtari te ndryshme, te krijoje, aplikoje dhe te perkrahe programe me karakter humanitar. Te kryeje veprime te cilat konsistojne ne ofrimin e shëbrimeve falaj, kujdes per te gjitha moshat dhe gjinite e njerezve, me qellim mireqenie, ruajtje e mbrojtje dinjiteti dhe sigurimin e perimiresimin e cilesise se jetes. Te ndihmoje familjet ne nevoje. Te nxise dhe te krijoje mundesi per punesimin e te rinjve. Te promovojë solidaritetin mes njerezve dhe krijimin e mundesive te arsimimit. Te hape kurse te ndryshme profesionale (rrobaqepesi, kurse ne gjuhe te huaja, etj). Te mbeshtes dhe marre masa per ngrijten e nje sistemi efikas te ndihmes psikologjike te njerezve te traumatizuar dhe te ndihmes emergjente ne raste te fatkeqesive natyrore. Te krijoje mundesite e hapjes se ambienteve te vecanta ku do te behet te mundur ofrimi i shërbimeve te ndryshme per njerez ne nevoje.

Me vendimin nr. 576/1, date 03.10.2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur depozitimi i vendimit nr. 1 date 03.08.2018 te Bordit drejtues ne te cilin eshte vendosur: Zevendesimi i vendit bosh te lene nga z. Muharrem Naçi (i ndjeri) me z. Marvin Naçi. Me vendimin nr. 2, date 03.08.2018 te brodit drejtues eshte vendosur: Ndryshimin e nenit 23.1 "Perberja e Organeve te Para Drejtuese/ Anetaret te Bordit Drejtues" te Statutit duke shtuar dhe dy anetare te rinj, konkretisht zj. Fatime Naçi dhe z. Andi Qinami. Me vendimin nr. 3, date 03.08.2018 te Bordit

drejtues, është vendosur: Ndryshimi i selisë nga Rr. Zonja Curre, Pallati "Ermir – Star", kati i parë, Tiranë, Shqipëri në Rr. "Ali Demi", nr. 25, kati i parë Tiranë, Shqipëri. Me vendimin nr. 4, datë 03.08.2018 të Bordit drejtues është vendosur Shtimin e nenit 16 "administratë" të statutit me gërmen A në të cilët të parashikohet koncepti i "Vullnetarit".

Ndryshime të metejshme nuk ka.

SEKRETARE REGJISTRIT TË OJF-ve

Besa KORBECI



allat "Ermir -
te Tiranë,
osur



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË



Nr. 673 Regjistri Themeltar
Date 31.08.2018 Regjistrimi

Nr.576/1 Vendimi
Date 03.10.2018 Vendimi

VENDIM
PËR DEPOZITIM NË REGJISTRIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Sot, me datë 03.10.2018 unë **Julian Haxhiu**, Gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën dhe aktet e paraqitura nga Fondacionit "FIRDEUS përfaqësuar nga Ilir Naçi, i cili kërkoi depozitimin e Vendimit Nr.1 datë 26.03.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit Fondacionit "FIRDEUS", Vendimit Nr.2 datë 26.03.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit Fondacionit "FIRDEUS", Vendimit Nr.3 datë 26.03.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit Fondacionit "FIRDEUS", Vendimit Nr.4 datë 26.03.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit Fondacionit "FIRDEUS"

KONSTATOVA

Se Fondacionit "Firdeus është regjistruar, si organizatë jofitimprurëse në formën e Fondacionit si me Vendimin Nr. 576 dt.15.12.2016, me seli në Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje statutin dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Bordi Drejtues i Fondacionit "FIRDEUS me Vendimin Nr.1 datë 03.08.2018
ka vendosur:

- Zëvendësimi i vendit bosh të lënë nga Z. Muharrem Naçi(i ndjeri) me Z. Marvin Naçi.

Bordi Drejtues i Fondacionit "FIRDEUS me Vendimin Nr.2 datë 03.08.2018
ka vendosur:

- Ndryshimin e Nenit 23.1 "Përbërja e Organeve të Para Drejtuese/Anëtarë të Bordit Drejtues" të Statutit duke shtuar dhe dy anëtarë të rinj, konkretisht Zj. Fatime Naçi dhe Z. Andi Qinami.

Bordi Drejtues i Fondacionit "FIRDEUS me Vendimin Nr.3 datë 03.08.2018
ka vendosur:

- Ishte: Rr. Zonja Curre", Pallati "Ermir - Star", kati i parë, Tiranë, Shqipëri.
Të bëhet: Rr. "Ali Demi" Nr. 25, kati i parë, Tiranë, Shqipëri.

Bordi Drejtues i Fondacionit "FIRDEUS me Vendimin Nr.4 datë 03.08.2018
ka vendosur:

- Shtimin e Nenit 16 "Administrata" të Statutit me gërmën A, në të cilët të parashikohet koncepti i "Vullnetarit".

Vendimi i mësipërm është marrë në përputhje me statutin e Fondacionit FIRDEUS dhe në përputhje me ligjin Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar.

Për sa më sipër, kërkesa e paraqitur është e mbështetur në aktet e fondacionit dhe në dispozitat ligjore dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar me ligjin nr.9814, datë 04.10.2007 e ligjin nr.92/2013 si dhe në mbështetje të ligjit nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse".

VENDOSA

Pranimin e kërkesës.

Depozitimn e Vendimit Nr.1 datë 03.08.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit FIRDEUS".

Depozitimn e Vendimit Nr.2 datë 03.08.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit FIRDEUS".

Depozitimn e Vendimit Nr.3 datë 03.08.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit FIRDEUS".

Depozitimn e Vendimit Nr.4 datë 03.08.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit FIRDEUS".

Urdhërohet Zyra e Regjistrimit e Organizatave Jofitimprurëse për pasqyrimin e ndryshimeve në kolonat përkatëse të regjistrit.

Datë 03.10.2018.



AKTI I THEMELIMIT

I

Fondacionit "FIRDEUS"



Sot më datën 09.11.2016, në Tiranë, Shqipëri, Z. Elvis Naçi shtetas shqiptar, lindur më 07.04.1977, në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. H70407042V; shpreh vullnetin e tij për themelimin e Fondacionit "FIRDEUS" dhe mbështetur në dispozitat e Kodit Civil dhe të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, harton këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

Neni 1

Themeluesi

1.1 Krijohet Fondacioni "FIRDEUS", në formën e një organizate jofitimprurëse.

1.2 Themelues i Fondacionit "FIRDEUS" është Z. Elvis Naçi.

Neni 2

Lloji, Emri dhe Vula

2.1 Fondacioni "FIRDEUS" (referuar më poshtë si Fondacioni) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse, që mbështet dhe zhvillon tek individit dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut.

2.2. Vula e Fondacionit është në ngjyrën blu, në formë të rumbullakët dhe do të përmbajë emrin 'Fondacioni FIRDEUS' dhe vendin e themelimit të Fondacionit, 'Tiranë, Albania'.

2.3 Emri dhe Vula e Fondacionit duhet të figurojnë në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del nga Fondacioni.

2.4 Në marrdhëniet me organizmat e huaja ose në pjesëmarrjet në veprimtari ndërkombëtare, do të njihet me emërtimin anglisht 'Foundation FIRDEUS'.

Neni 3

Selia

3.1 Selia e Fondacionit "FIRDEUS" ndodhet në adresën: Rr. "Zonja Çurre", Pallati "Ermir-Star", kati 1, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Vendndodhja e selisë mund të ndryshohet me vendim të Bordit Drejtues.

Neni 4
Shtrirja Territoriale

4.1 Fondacioni "FIRDEUS" zhvillon aktivitetin e tij pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Fondacioni "FIRDEUS" mund të krijojë degë të tij në çdo njëri prej tjetër administrativo-territoriale të Shqipërisë.

4.2 Fondacioni "FIRDEUS" njëkohësisht mund të çelë degë ose filiale edhe në shtete të huaja, sipas legjislacionit të vendeve përkatëse.

Neni 5
Qëllimi dhe Objekti

5.1 Fondacioni "FIRDEUS" ka për qëllim dhe si fushë të veprimtarisë së vet:

1. Të kryejë veprimtari të ndryshme, të krijojë, aplikojë dhe të përkrahë programe me karakter humanitar.
2. Të kryerje veprime të cilat konsistojnë në ofrimin e shërbimeve falas, kujdes për të gjitha moshat dhe gjinitë e njerëzve, me qëllim mirëqenie, ruajtje e mbrojtje dinjiteti dhe sigurimin e përmirësimit e cilësisë së jetës.
3. Të ndihmojë familjet në nevojë.
4. Të nxisë dhe të krijojë mundësi për punësimin e të rinjve.
5. Të promovojë solidaritetin mes njerëzve dhe krijimin e mundësive të arsimimit.
6. Të hapë kurse të ndryshme profesionale (rrobaqepësi, kurse në gjuhë të huaja, etj).
7. Të mbështesë dhe marrë masa për ngritjen e një sistemi efikas të ndihmës psikologjike të njerëzve të traumatizuar dhe të ndihmës emergjente në raste të fatkeqësive natyrore.
8. Të krijojë mundësitë e hapjes së ambienteve të veçanta, ku do të bëhet e mundur ofrimi i shërbimeve të ndryshme për njerëz në nevojë.
9. Të kryejë veprimtari për ngritjen dhe sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme shoqërore, edhe aktivitete fetare.
10. Krijimin e kushteve bamirëse me qëllim arsimimi e edukimi, sigurimin e mbështetjes të teknologjisë së lartë për të përmirësuar kujdesin shëndetësor, nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore nëpërmjet inicimit, administrimit, zbatimit të projekteve konkrete, të koncepteve dhe praktikave në fushat përkatëse në përputhje me vlerat e organizatës.
11. Krijimin dhe administrimin e projekteve apo organizmave të tjera si persona juridikë ose jo, për realizimin e programeve të ndryshme të zhvillimit në fushën mjekësore, të përkujdesjes shëndetësore, të edukimit të të gjitha niveleve, në përmbushje të qëllimit të Fondacionit.
12. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme sipas qëllimit të fondacionit në fushën shëndetësore, sociale, shpirtërore, kulturore, atë ekonomike, dhe të fushave të tjera shoqërore.

- 
- 
13. Sigurimin e mbështetjes së nevojshme për aktivitetet dhe programet e Fondacionit, nëpërmjet ndihmës apo kontributit të personave fizikë apo juridikë, vendas ose të huaj.
 14. Promovimin e qëllimit dhe aktivitetit të Fondacionit apo të projekteve të ndryshme, përmes medias televizive, radiofonike, të shtypshkruar, apo internetit, si dhe çdo platforme tjetër të komunikimit masiv.
 15. Administrimin e pasurisë së Fondacionit në përmbushje të qëllimit të Fondacionit.
 16. Monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe programeve të Fondacionit për realizimin me cilësi të qëllimit të Fondacionit.
 17. Sigurimin dhe zbatimin në praktikë nga vetë Fondacioni apo nëpërmjet projekteve apo programeve të tij, të koncepteve dhe praktikave innovative në fushat e mbuluara nga qëllimi i Fondacionit.
 18. Ofrimin e ndihmës praktike dhe shërbimeve në të gjitha aspektet e nevojshme për projektet, programet apo organizatat e krijuara nga Fondacioni në përmbushje të qëllimeve të Fondacionit.
 19. Ofrimin dhe krijimin e mundësive apo platformave të ndryshme, si dhe ngritjen e grupeve të këshillimit për zhvillimin e diskutimeve në fushat të cilat përfshihen në qëllimin e Fondacionit.
 20. Çdo lloj aktiviteti tjetër që çmohet i arsyeshëm në të mirë dhe në interes të publikut, i paparashikuar ose jo në qëllimin e Fondacionit dhe që nuk është ndaluar shprehimisht me ligj.

Neni 6 Kohëzgjatja

- 6.1 Fondacioni "FIRDEUS" do të zhvillojë aktivitetin për një periudhë kohe të pacaktuar.
- 6.2 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Fondacionit mund të ndryshohet me vendim të Bordit Drejtues.

Neni 7 Ndalimi i Shpërndarjes së Fitimeve

Ndalohet çdo formë e shpërndarjes së fitimit ose përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e Fondacionit "FIRDEUS", prej personave që janë subjekt i Statutit, Aktit të Themelimit, rregulloreve dhe çdo akti tjetër të Fondacionit, përveç detyrimeve në formën e pagave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës dhe kontrata të tjera të ngjashme ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi për llogari të organizatës jofitimprurëse.

Neni 8 Burimet Financiare

8.1 Vlera e pasurisë së Fondacionit "FIRDEUS" është 100.000 (një qind mijë lekë) e krijuar si kontribut fillestar i themeluesit dhe e derdhur në llogarinë bankare të Fondacionit.

8.2 Burimet e ardhurave të organizatës jofitimprurëse janë të ardhurat nga kufizimi i kur ka të tilla, fonde, grante dhe dhurimet/donacionet e ofruara nga subjektet fizike apo juridikë privatë vendas ose të huaj, nga veprimtaria e Fondacionit në përputhje me qëllimin dhe objektin e tij bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse.

Neni 9

Organet Drejtuese të Fondacionit

9.1 Organet Drejtuese të Fondacionit janë:

1. Bordi Drejtues (BD)
2. Drejtori Ekzekutiv (DE)

Neni 10

Përfaqësimi

10.1 Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit është personi që përfaqëson Fondacionin në marrdhëniet me personat e tretë fizikë dhe juridikë.

10.2 Deri në emërimin e Drejtorit Ekzekutiv, nga mbledhja e parë e Bordit Drejtues, funksionet e përfaqësimit i kryen Z. Elvis Naçi, si themelues i Fondacionit.

Neni 11

Bilancet Financiare

Veprimet ekonomiko-financiare të Fondacionit fillojnë më datë 1 Janar dhe mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik, duke bërë përjashtim për vitin e parë.

Neni 12

Përbërja e Organeve të Para Drejtuese

12.1 Anëtarë të Bordit Drejtues, janë:

- Elvis Naçi, themelues i Fondacionit.

- Muhammed Naçi

- Florion Brinjaj

Neni 13
Dispozita të fundit

13.1 Fondacioni "FIRDEUS" do të ketë personalitetin e vet juridik qysh nga dita e regjistrimit në gjykatë, sipas dispozitave ligjore në Republikën e Shqipërisë.

13.2 Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar.

13.3 Mosmarrëveshjet lidhur me themelimin e Fondacionit zgjidhen me mirëkuptim, dhe kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga gjykata kompetente.


Ky Akt-Themelimi hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje me vlerë dhe fuqi të njëjtë.

Ky Akti i Themelimit dhe Statuti u firmosën nga Themeluesi.

THEMELUESI


Elvis NAÇI

Elvis Naçi



OMA E NOTERI
NOTER: SAIMIR S.
STUDIO: SHESHI:
RRUGA: "HOXHA"
TEL.: + 04/2250583

RIKLIKA E SHQIPERISE
OMA E NOTERISE TIRANE
SHERE AIDA SHAMETI
Rep.



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me datë 09 Nentor 2016 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë) ditën e Merkure, unë Notere **AIDA SHAMETI**, anëtare e dhomës së noterisë Tiranë, me zyrë në adresën Rruga " Reshit Petrela", Kompleksi i llateve "USLUGA", Tiranë, redaktoj këtë vërtetim nënshkrimi me kërkesë të personit të identifikuar më shtë:

vis **NAÇI** i biri i Muharrem e Dylbere lindur ne Tirane me 07. 04. 1977, banues në Tiranë, (deklaruar prej) me adrese Lagja "Ali Demi", shtetas shqiptar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi me mër personal H70407042V, me cilesine e themelusit te Fondacionit "FIRDEUS".

rsoni e mësipërm është madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili nënshkroi sot në praninë te dokumentin bashkëlidhur Akti i Themelimit te Fondacionit "FIRDEUS" të redaktuar jashtë kësaj zyre teriale.

ë noterja pasi e gjeta në përputhje me parashikimet e ligjit "Ligjit për Noterinë", e vërtetoj rregullisht ashkrimin e tij në aktin bashkëlidhur.

NOTERE
AIDA E SHAMETI

OMA E NOTERISË TIRANË
NOTER: SAIMIR S. SHATKU
STUDIO: SHESHI: "AVNI RUSTEMI"
RRUGA. "HOXHA TAHSIM"
TEL.: + 04/2250583/MOB. 0672557851



VËRTETIM NOTERIAL

(Njësim me origjinalin)

Unë Noteri SAIMIR S. SHATKU, vërtetoj se dokumenti/at i fotokopjuar/a me titullin e mëposhtëm:

* Vertetim Nenshkrimi me Nrt. 2619, dt. 09.11.2016 (Notere AIDA E. SHAMETI), ne Akt-Themelimin e Fondacionit "FIRDEUS".

Lëshuar më 08/03/2018, me kërkesë të shtetasit/es: Z. ELVIS NAÇI, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 026076036 dhe me nr. personal: H70407042N.

Vërtetohet se dokumenti/at janë të njëjtë me origjinalin, të cilat nuk kanë korrigjime, shtesa, fshirje apo shenja të tjera të veçanta.

Vërtetimi i dokumenteve të bashkëlidhura bëhet në përputhje me Nenin 56 të Ligjit 7829, date 01/06/1994 "Për Noterinë" dhe të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë me Nr. 6291, pika 7, datë 17/08/2005.

NOTER
SAIMIR S. SHATKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

NUMRI SERIAL: 10150274941



10150274941

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të Tatueshëm:
FONDACIONI "FIRDEUS"

Me adresë kryesore:
RRUGA ALI DEMI, NR.25, KATI 1, Tiranë

I jepet ky numër identifikimi (NIPT/SSN):
L716274530

DATA E LËSHIMIT: 12.10.2018

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë

DREJTORI

Kjo certifikatë është pronë e Ministrisë së Financave dhe duhet të kthehet në qoftë se ka ndryshime në detaje ose nuk ka më detyrime ligjore për të qenë person i tatueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L51308022F	
2. Data e Regjistrimit	08/01/2015	
3. Emri i Subjektit	SPITALI CONTINENTAL	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	06/01/2015	
6. Kohëzgjatja	Nga: 06/01/2015	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga Ali Demi, Ambientet e ish Kombinatit Poligrafik, Godinë 2 Katëshe, ngjitur me Kryegjyshatën	
8. Kapitali	100.000.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukurave diagnostikuese e kuruese dhe qendrave ambulatorie te diagnostikimit ne territorin e Shqiperise, konsulence ne kete fushe. Organizimi i qendrave te trainimit dhe programe per edukimin e trainimin e daktoreve, infermiereve dhe personelit administrativ. Aktivitet tregtar per import-export te aparaturave dhe pajisjeve mjekesore, mjete farmaceutike, sherbime logjistike per materiale/lende farmaceutike te perdorura ne strukturat e diagnostikimit. Funksionimi dhe administrimi i farmacive te shitjes me pakice dhe tregtimi me pakice i barnave dhe produkteve farmaceutike. Funksionimi dhe administrimi i restoranteve dhe i lokaleve, bar kafe etj. Ofrimin e sherbimeve mjekesore spitalore jopublike, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me marreveshjet nderkombetare per sherbimet shendetesore transkufitare.	
10. Administratori/ët	Hysen Buzali	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 07/06/2019	Deri: 07/06/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	MGB	
12.1 Vlera e kapitalit	Para:	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100.000.000,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	1,00	
	100,00	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: SPITALI CONTINENTAL E-Mail: cekubuzali@hotmail.com Telefon: 0682014420 0697070400	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 08/11/2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L51308022F
2. Data e Regjistrimit	08/01/2015
3. Emri i Subjektit	SPITALI CONTINENTAL
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	06/01/2015
6. Kohëzgjatja	Nga: 06/01/2015 Deri:
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga Ali Demi, Ambientet e ish Kombinatit Poligrafik, Godinë 2 Katëshe, ngjitur me Kryegjyshatën
8. Kapitali	100.000.000,000
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,000
9. Objekti i aktivitetit	Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukurave diagnostikuese e kuruese dhe qendrave ambulatorie te diagnostikimit ne territorin e Shqiperise, konsulence ne kete fushe. Organizimi i qendrave te trainimit dhe programe per edukimin e trainimin e doktoleve, infermiereve dhe personelit administrativ. Aktivitet tregtar per import-export te aparaturave dhe pajisjeve mjekesore, mjete farmaceutike, sherbime logjistike per materiale/lende farmaceutike te perdorura ne strukturat e diagnostikimit. Funksionimi dhe administrimi i farmacive te shitjes me pakice dhe tregtimi me pakice i barnave dhe produkteve farmaceutike. Funksionimi dhe administrimi i restoranteve dhe i lokaleve, bar kafe etj. Ofrimin e sherbimeve mjekesore spitalore jopublike, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me marreveshjet nderkombetare per sherbimet shendetesore transkufitare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

10. Administratori/ët	Hysen Buzali	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 07/06/2019	Deri: 07/06/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	MGB	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000.000,000	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,000	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,000	
12.6 Komentet (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: SPITALI CONTINENTAL E-Mail: cekubuzali@hotmail.com Telefon: 0682014420 0697070400	
15. Statusi:	Aktiv	

Lista e Dokumenteve:

Statuti (nëse është hartuar si dokument i ndryshëm nga akti i themelimit)

Mandati bankar ose vertetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para - (nëse kapitali është paguar)

Regjistrimi Fillestar: CN-786272-01-15

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i të dhënave të regjistruara
1. 29/01/2015	Numri i cështjes: CN-834246-01-15 Arsyet e hapjes së cështjes: Depozitim i vendimit Nr.2, datë 22.01.2015, ku është vendosur ndryshimi i selisë së shoqërisë. <u>Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme në Adresat e Aktivitetit:</u> është Shtuar Adresa: "Tirane; TIRANE; Tirane; ; TIRANE; Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga Ali Demi, Ambientet e ish Kombinatit Poligrafik, Godinë 2 Katëshe, ngjitur me Kryegjyshitën; " është Hequr Adresa: "Tirane; TIRANE; Tirane; ; TIRANE; Lagjja Komuna e Parisit, Njësia Bashkiake nr.5, Pallati Kristi Co, Kati 1, nr.4; " Lista e Dokumenteve:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



	<u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u>
2. 10/02/2015	Numri i ceshtjes: CN-857755-02-15 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit Nr.03 date 05.02.2015 te asamblese se ortakeve ku eshte vendosur hapjen e nje drese sekondare si dhe ndryshimin e adresese elektronike dhe numrit te kontaktit. <u>Telefon</u> ishte ("0672055554") u be ("0682014420") <u>E-Mail</u> ishte ("") u be ("cekubuzali@hotmail.com") <u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit:</u> eshte Shtuar Adresa: "Berat; SKRAPAR; Polican; ; POLICAN; Lagjja "Qender", pallati nr.93/3, shkalla nr.1, kati I-rë; " Lista e Dokumenteve: <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u>
3. 15/04/2015	Numri i ceshtjes: CN-004133-04-15 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i vendimit date 14.04.2015, te asamblese se ortakeve te shoqerise, ku eshte vendosur: Hapja e adreses dytesore. <u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit:</u> eshte Shtuar Adresa: "Fier; LUSHNJE; Lushnje; ; LUSHNJE; Lagjia Xhevdet Nepravishta, (Lokal tregtie 1 - kat, Banese 2 - kate), Pasuria nr. 25/202, Zona Kadastrale 8571; " Lista e Dokumenteve: <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u>
4. 10/07/2015	Numri i ceshtjes: CN-143502-07-15 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Kërkesës të administratorit të shoqërisë, datë 09.07.2015, ku është kërkuar: Mbyllja e adresës dytësore të ushtrimit të aktivitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<u>Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme në Adresat e Aktivitetit:</u> është Hequr Adresa: "Berat; SKRAPAR; Polican; ; POLICAN; Lagjja "Qender", pallati nr.93/3, shkalla nr.1, kati I-rë.; " Lista e Dokumenteve: <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Mandati bankar ose vërtetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para - (nëse kapitali është paguar)</u> <u>Vendim i asamblese së përgjithshme</u>
5. 02/02/2016	Numri i ceshtjes: CN-532486-02-16 Arsyet e hapjes së ceshtjes: Depozitimi i vendimit të asamblese së ortakëve, datë 22.01.2016 ku është vendosur: Miratimi i shitjes së 10% të kuotave të kapitalit nga Z.Hysen Buzali në favor të Z.Robert Bano, miratimi i shitjes së 18.75% të kuotave nga Z.Hergys Rreli në favor të Znj. Greta Lena. Depozitimi i kontratës së shitjes, datë 22.01.2016. <u>Numri i aksioneve ishte "3,00" u bë "4,00"</u> <u>Vlera e aksionit ishte "33.333.333,33" u bë "25.000.000,00"</u> <u>Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek ortakët individ:</u> është shtuar ortaku: ("Greta Lena") Numri i aksioneve "1,000" Përqindja në kapital "18,750" Kontributi në para "18.750.000,000" Kane ndryshuar të dhënat për ("Hysen Buzali") , Kontributi në para ishte ("25.000.000,00") u bë ("15.000.000,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Hysen Buzali") , Përqindja në kapital ishte ("25,00") u bë ("15,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Hergys Rreli") , Kontributi në para ishte ("37.500.000,00") u bë ("18.750.000,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Hergys Rreli") , Përqindja në kapital ishte ("37,50") u bë ("18,75") Kane ndryshuar të dhënat për ("Robert Bano") , Kontributi në para ishte ("37.500.000,00") u bë ("47.500.000,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Robert Bano") , Përqindja në kapital ishte ("37,50") u bë ("47,50") Lista e Dokumenteve: <u>Vendim i asamblese së përgjithshme</u> <u>Mandati bankar ose vërtetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para - (nëse kapitali është paguar)</u> <u>Transferim i kuotave të kapitalit</u>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



	<u>Dokumenti i autorizimit</u>
6. 23/03/2016	Numri i ceshtjes: CN-610131-03-16 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i kerkese se administratorit te shoqerise, date: 23.03.2016, ne te cilin eshte kerkuar: Hapja e nje adrese dytesore. <u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit:</u> eshte Shtuar Adresa: "Tirane; TIRANE; Tirane; ; TIRANE; Brenda Ambienteve të "Spitalit Continental", Sh.p.k, Kati 1 (Bar - Kafe); " Lista e Dokumenteve: <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u>
7. 27/04/2016	Numri i ceshtjes: CN-669160-04-16 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim I Vendimit të Asamblesë së Ortakëve Nr.03, dt. 25.04.2016 për transferimin e kuotes nëpërmjet Kontratës Shitjes së Kuotave të Kapitalit dhe miratimin e Ortakut te ri në Shoqëri. Depozitimi I Kontratës së Shitjes Kuotave dt. 25.04.2016. <u>Numri i aksioneve ishte "4,00" u be "5,00"</u> <u>Vlera e aksionit ishte "25.000.000,00" u be "20.000.000,00"</u> <u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortakët individ:</u> eshte shtuar ortaku: ("Danida Liçka") Numri i aksioneve "1,000" Përqindja ne kapital "7,500" Kontributi ne para "7.500.000,000" Kane ndryshuar te dhenat per ("Robert Bano") , Kontributi në para ishte ("47.500.000,00") u be ("40.000.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("Robert Bano") , Përqindja në kapital ishte ("47,50") u be ("40,00") Lista e Dokumenteve: <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Transferim i kuotave te kapitalit</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u>
8. 30/07/201	Numri i ceshtjes: CN-856451-07-16 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

6	FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i pasqyrave financiare per vitin 2015. Lista e Dokumenteve: <u>Pasqyra e ndryshimeve në kapitalet e veta</u> <u>Pasqyra e ardhurave dhe të shpenzimeve</u> <u>Pasqyra e rrjedhjes së parasë (cash flow)</u> <u>Anekset e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues</u> <u>Akti i miratimit të bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar)</u> <u>Bilanci Kontabël</u>
9. 03/08/2016	Numri i ceshtjes: CN-862687-08-16 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Vendimit Nr.04, date 21.07.2016, per miratim te transferimit te kuotave si dhe Kontrates se shitjes se kuotave date 21.07.2016. <u>Numri i aksioneve ishte "5,00" u be "6,00"</u> <u>Vlera e aksionit ishte "20.000.000,00" u be "16.666.666,67"</u> <u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortakët individ:</u> eshte shtuar ortaku: ("Arian Skuka") Numri i aksioneve "1,000" Përqindja ne kapital "5,000" Kontributi ne para "5.000.000,000" Kane ndryshuar te dhenat per ("Hysen Buzali") , Kontributi në para ishte ("15.000.000,00") u be ("10.000.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("Hysen Buzali") , Përqindja në kapital ishte ("15,00") u be ("10,00") Lista e Dokumenteve: <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Transferim i kuotave te kapitalit</u>
10. 02/12 /2016	Numri i ceshtjes: CN-053681-12-16 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i vendimit Nr.5, date 24.11.2016, ku eshte vendosur kalimi i 5% te kuotave nga z.Hysen Buzali dhe 17,5% nga z.Robert Bano ne favor te zj.Greta Lena, zj.Danida Liçka dhe z.Hergys Rreli. Depozitim i kontrates se shitjes se kuotave date 24.11.2016, per kalimin e 5% dhe 17,5% te kuotave ne favor te zj.Greta Lena, zj.Danida Liçka dhe z.Hergys Rreli. Depozitim i kerkeses date 01.12.2016, per mbylljen e nje adrese dytesore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



	Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: eshte Hequr Adresa: "Tirane; TIRANE; Tirane; ; TIRANE; Brenda Ambienteve të "Spitalit Continental", Sh.p.k, Kati 1 (Bar - Kafe); " Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortakët individ: Kane ndryshuar te dhenat per ("Hergys Rreli") , Kontributi në para ishte ("18.750.000,00") u be ("22.500.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("Hergys Rreli") , Përqindja në kapital ishte ("18,75") u be ("22,50") Kane ndryshuar te dhenat per ("Robert Bano") , Kontributi në para ishte ("40.000.000,00") u be ("22.500.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("Robert Bano") , Përqindja në kapital ishte ("40,00") u be ("22,50") Kane ndryshuar te dhenat per ("Hysen Buzali") , Kontributi në para ishte ("10.000.000,00") u be ("5.000.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("Hysen Buzali") , Përqindja në kapital ishte ("10,00") u be ("5,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("Danida Liçka") , Kontributi në para ishte ("7.500.000,00") u be ("22.500.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("Danida Liçka") , Përqindja në kapital ishte ("7,50") u be ("22,50") Kane ndryshuar te dhenat per ("Greta Lena") , Kontributi në para ishte ("18.750.000,00") u be ("22.500.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("Greta Lena") , Përqindja në kapital ishte ("18,75") u be ("22,50") Lista e Dokumenteve: <u>Imazhi i shenjës dalluese të aktivitetit</u> <u>Transferimi i kuotave të kapitalit</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Mandati bankar ose vërtetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para - (nëse kapitali është paguar)</u> <u>Vendimi i asamblesë së përgjithshme</u>
11. 13/11 /2017	Numri i ceshtjes: CN-540805-11-17 Arsyet e hapjes së ceshtjes: Depozitimi i vendimit të asamblesë së ortakëve Nr. 6 datë 09.10.2017 për largimin nga shoqëria të ortakëve znj. Danida Liçka dhe Greta Lena të cilat tërhoqën nga zotërimi i kuotave dhe kalimi i kuotave të tyre tek ortakët e shoqërisë Robert Bano dhe Hergys Rreli. Vendimi i asamblesë së ortakëve Nr. 06/1 datë 16.10.2017 për miratimin e raportit të ekspertit kontabel z. Bujar Bendo. Largimin përfundimisht nga shoqëria të ortakëve Danida Liçka dhe Greta Lena dhe kuotat e kapitali të tyre i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	panenshkuar dhe i pashlyer ka kaluar dhe është shlyer dhe likujduar nga ortakët Robert Bano dhe Hergys Rreli për pjesën takuese të kapitalit të nënshkuar duke kaluar pasketë në zotërim të tyre me të drejta dhe detyrimet që rrjedhin bazuar në ligj. Ortakët e shoqërisë behen: Robert Bano zotëruar në një kuota 45% me vlerë 45.000.000 leke, Hergys Rreli zotëruar në një kuota 45% me vlerë 45.000.000 leke, Arjan Skuka zotëruar në një kuota 5% me vlerën 5.000.000 leke, Hysen Buzali zotëruar në një kuota 5% me vlerë 5.000.000 leke. Raporti i ekspertit datë 16.10.2017. Deklaratë e ortakëve të larguara datë 01.10.2017. Numri i aksioneve ishte "6,00" u bë "4,00" <u>Vlera e aksionit ishte "16.666.666,67" u bë "25.000.000,00"</u> <u>Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek ortakët individ:</u> është larguar ortakët: ("Danida Liçka") është larguar ortakët: ("Greta Lena") Kane ndryshuar të dhënat për ("Robert Bano"), Kontributi në para ishte ("22.500.000,00") u bë ("45.000.000,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Robert Bano"), Përqindja në kapital ishte ("22,50") u bë ("45,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Hergys Rreli"), Kontributi në para ishte ("22.500.000,00") u bë ("45.000.000,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Hergys Rreli"), Përqindja në kapital ishte ("22,50") u bë ("45,00") <u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Vendim i asamblesë së përgjithshme</u> <u>Regjistrime të tjera sipas nenit 45 të ligjit për QKR</u> <u>Mandati bankar ose vërtetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para - (nëse kapitali është paguar)</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u>
12. 03/11 /2017	Numri i çështjes: CN-546027-11-17 (APLIKIM PËR DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes së çështjes: Depozitimi i Bilancit të vitit 2016. <u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Akti i Pagesës së kundërvajtjes administrative (nëse ka)</u> <u>Akti i miratimit të bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individit tregtar</u> <u>Bilanci Kontabël</u>
13. 05/12 /2017	Numri i çështjes: CN-579600-12-17 Arsyet e hapjes së çështjes: Depozitimi i Kontrates së Shitjes, datë 01.12.2017, ndërmjet paleve shitëse Robert Bano (25% të kuotave) Hergys Rreli (20% të kuotave) dhe paleve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



	blerese Hysen Buzali. <u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortakët individ:</u> Kane ndryshuar te dhenat per ("<i>Hysen Buzali</i>") , Kontributi në para ishte ("5.000.000,00") u be ("50.000.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("<i>Hysen Buzali</i>") , Përqindja në kapital ishte ("5,00") u be ("50,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("<i>Robert Bano</i>") , Kontributi në para ishte ("45.000.000,00") u be ("20.000.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("<i>Robert Bano</i>") , Përqindja në kapital ishte ("45,00") u be ("20,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("<i>Hergys Rreli</i>") , Kontributi në para ishte ("45.000.000,00") u be ("25.000.000,00") Kane ndryshuar te dhenat per ("<i>Hergys Rreli</i>") , Përqindja në kapital ishte ("45,00") u be ("25,00") Lista e Dokumenteve: <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Transferim i kuotave te kapitalit</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u>
14. 09/02 /2018	Numri i ceshtjes: CN-656684-02-18 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Vendimit të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë, datë 29.01.2018, ku është vendosur: Largimin e Z.Hysen Buzali nga detyra e administratorit të shoqërisë. Emërimin e Zj.Lefteri Liçka si administratorë e re e shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare. <u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratorët:</u> <u>eshte shtuar administratori: ("<i>Lefteri Liçka</i>")</u> Nga data "29/01/2018" Ne daten "29/01/2023" <u>eshte larguar administratori: ("<i>Hysen Buzali</i>")</u> Lista e Dokumenteve: <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u>
15. 16/05	Numri i ceshtjes: CN-783421-05-18



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

/2018	Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit date 15.05.2018 ku eshte vendosur: Miratimin e rezultatit dhe pasqyrave financiare per vitin 2017 per humbje ne shumen 55,015,466 leke e cila do te mbartet per kompesim nga fitimet e viteve te ardhshme. Miratohet raporti audit per pasqyrat financiare 2017 dhe emerohet audit ligjor per vitin vijues 2018 Z.Bujar Bendo me nr.79 license te leshuar nga IEKA. Ortaket brenda 6 muajve nga ky vendim duhet te marrin masa per financim dhe kapitalizim te shoqerise ne kushtet kur kapitalet e veta jane negative. Lista e Dokumenteve: <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u>
16. 28/07 /2018	Numri i ceshtjes: CN-885849-07-18 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i pasqyrave financiare per vitin 2017. Lista e Dokumenteve: <u>Bilanci Kontabël</u> <u>Raport Auditimi</u> <u>Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar)</u>
17. 12/09 /2018	Numri i ceshtjes: CN-926339-09-18 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit date 03.09.2018, ku eshte vendosur, ndryshimi i administratorit te shoqerise. Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratoret: <u>eshte shtuar administratori: ("Arbi Thereska")</u> Nga data "03/09/2018" Ne daten "03/09/2023" <u>eshte larguar administratori: ("Lefteri Liçka")</u> Lista e Dokumenteve: <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u>
18. 01/02 /2019	Numri i ceshtjes: CN-087327-01-19 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit te asamblese se ortakeve, date



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



	31.01.2019 ku është vendosur : Mbyllja e një adrese dytesore. <u>Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme në Adresat e Aktivitetit:</u> është Hequr Adresa: "Fier; LUSHNJE; Lushnje; ; LUSHNJE; Lagjia Xhevdet Nepravishta, (Lokal tregtie 1 - kat, Banese 2 - kate), Pasuria nr. 25/202, Zona Kadastrale 8571; " <u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para - (nese kapitali është paguar)</u> <u>Vendim i asamblese se përgjithshme</u>
19. 01/04 /2019	Numri i ceshtjes: CN-145592-03-19 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit, dt. 25.03.2019, ku është vendosur: - Miratim transferimi kapitali. Depozitimi i kontratës së shitjes, dt.25.03.2019. <u>Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek ortakët individ:</u> Kane ndryshuar të dhënat për ("Hysen Buzali") , Kontributi në para ishte ("50.000.000,00") u be ("5.000.000,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Hysen Buzali") , Përqindja në kapital ishte ("50,00") u be ("5,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Robert Bano") , Kontributi në para ishte ("20.000.000,00") u be ("65.000.000,00") Kane ndryshuar të dhënat për ("Robert Bano") , Përqindja në kapital ishte ("20,00") u be ("65,00") <u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Vendim i asamblese se përgjithshme</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para - (nese kapitali është paguar)</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Transferim i kuotave të kapitalit</u>
20. 11/06 /2019	Numri i ceshtjes: CN-222997-06-19 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit date 07.06.2019, ku është vendosur: Miratimi i largimit të Arbi Thereska dhe emerimin e Hysen Buzali si administrator i shoqërisë. <u>Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek administratorët:</u> <u>është shtuar administratori: ("Hysen Buzali") Nga data "07/06/2019" Në datën "07/06/2024"</u>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	eshte larguar administratori: ("Arbi Thereska") Lista e Dokumenteve: <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u>
